

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5527
E hënë, 16 korrik 2018
çmimi 0.40 €

Kemi dështim të komunikimit publiko-privat në harmoni me interesat ekonomike

INTERVISTË ME KRYETARIN E RI TË ODËS EKONOMIKE TË KOSOVËS (OEK), BERAT RUKIPI ■ FAQE 8-9



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCHGMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", MUHARREM NITAJ ■ FAQE 4-5

Partnerët e koalicionit qeverisës janë unikë për dialogun

- Është shumë me rëndësi që Kosova në Bruksel të shkojë me një zë

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka bërë me dije se koalicioni qeverisës është unik sa i përket dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se partnerët qeveritarë po angazhohen për arritjen

e konsensusit për këtë proces, pjesë e të cilit shpreson se do të jenë shumica e partive opozitare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se për AAK-në është jetike të ketë një konsensus politik jo vetëm për udhëheqësin e bisedimeve, por edhe

për platformën dhe për strategjinë, ose qasjen që do ta ketë Kosova në këtë proces. Sa i përket funksionimit të Kuvendit, Nitaj ka deklaruar se koalicioni qeverisës nuk do ta ketë problem çështjen e numrave dhe të fuqisë për të vepruar



AKTUALE

DY-TRI FJALË PËR MUNDËSINË E PROCESIT TË LUSTRIMIT ■ II

Shyqyri HAXHA



A DO TË BËHET KOSOVA KËTË VIT ME USHTRI? ■ 7



SOT VARROSET KAPITENI SEJDI KRASNIQI ■ 3

AMBASADORI NORVEGJEZ: TË RISHIKOHEN HOLLËSITË RRETH ASOCIACIONIT ■ 7

EKONOMI

LEKAJ: SË SHPEJTI KOSOVA BËHET ME PILOTË TË AVIACIONIT CIVIL ■ 8

KULTURË

INSTITUTI I HISTORISË SË KOSOVËS KRENOHET ME VEPRIMTARINË SHKENCORE TË PROF. DR. SABILE KEÇMEZI-BASHËS ■ 20

Prof. dr. Sabit SYLA



Franca, kampione e Botës ■ FAQE 3

Franca është kampione e botës për herë të dytë në historinë e saj, kurse Kroacia e përfundon e dyta Botërorin "Rusi 2018", që është një sukses historik për këtë reprezentacion. Në vendin e tretë ka përfunduar Belgjika, e katërta Anglia

Java e liberalizimit të vizave

Më në fund, Komisioni Evropian pritet që këtë javë ta japë rekomandimin për liberalizimin e vizave për Kosovën. Udhëheqësit shtetërorë kanë bërë me dije se rekomandimi i Komisionit Evropian për Parlamentin dhe

Këshillin e BE-së rreth kësaj çështje do të ndodhë më 17 ose 18 korrik. Ata janë shprehur të bindur se rekomandimi do të jetë pozitiv, duke u zotuar se Kosova do të jetë mjaft e kujdesshme në këtë proces ■ FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com


Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666



Kurz: Ballkani Perëndimor, prioritet i BE-së

VIENË, 15 KORRIK - Për Austrinë, Ballkani Perëndimor është një përparësi kryesore e politikave të saj të jashtme dhe evropiane, si

dhe Presidenca e saj, tha të dielën kancelari austriak Sebastian Kurz dhe u zotua t'i pezullojë negociatat mbi pranimin e Turqisë. Në

një intervistë për të përditshmen greke Kathimerini, Kurz vlerësoi se "ofrimi i perspektivave të ndershme dhe një rrugë e besueshme

për BE-në për vendet e Ballkanit Perëndimor do t'u shërbejë interesave politike, ekonomike dhe të sigurisë të BE-së".

Ndryshime në Qeverinë Rama, ikën Majko dhe shumë ministra

Burime të besueshme tregojnë se kryeministri Edi Rama ka vendosur ta ndryshojë kabinetin qeveritar, ndërkohë opozita kërkon kokën e kryeministrit dhe jo ndryshime apo arnime në qeveri. Rama zëvendëskryemnistren Senida Mesi po e piketon si kandidat për kryetare bashkie në Shkodër, kurse Pandeli Majkon si kandidat në Korçë për kryetar bashkie



TI RANË, 15 KORRIK - Burime të besueshme tregojnë se kryeministri Edi Rama ka vendosur përfundimisht për ndryshimin e kabinetit qeveritar. Nuk ka asnjë hezitim te Edi Rama. Por, opozita kërkon kokën e kryeministrit, e jo ndryshime apo arnime në Qeveri.

Lulzim Basha dhe Monika Kryemadhi kanë paralajmëruar se në vjeshtë do ta rrëzojnë kryeministrin dhe se nuk i duhen popullit arnimet që mund të bëjë Edi Rama në Qeveri për interesa të oligarkëve. Ndërsa Edi Rama, pas ngritjes së tensionit politik në vend si dhe duke ditur se vjeshta do të jetë e nxehtë dhe me përplasje të forta me popullin opozitar, ka piketuar ndryshime të reja rrënjësore në kabinet. Kur themi ndryshime rrënjësore, puna arrin se mund të largojë 2/3 e

Qeverisë. Sipas burimeve, mbeten prapë në Qeveri vetëm Fatmir Xhafa, Ditmir Bushati, Ogerta Manastirliu, Olta Xhaçka, Niko Peleshi dhe mundet Damian Gjijnuri, të cilin e ka të sigurt si person për lidhjet në ShBA. Lindita Nikollën dhe Blendi Klosin do t'i kthejë në krye të fushatës elektorale për fushatën zgjedhore, pasi të dy Rama i quan njerëzit e punës në PS. Dy nga emrat në kabinet, zëvendëskryemnistren Senida Mesi po e piketon si kandidatë për kryetare bashkie në Shkodër, kurse Pandeli Majkon për kandidat në Korçë për kryetar bashkie. Kryeministri synon të marrë për herë të parë bashkinë e Shkodrës, ndaj e ka piketuar largimin e saj që tani pasi duhet të merret me fushatën në Shkodër. Ndërsa Pandeli Majkon, pas

incidentit që ai i bëri me mosvotimin e Ligjit për Teatrin, e ka ndarë mendjen që ta largojë sa më larg selisë së PS-së. Duke i ofruar Korçën, dhe nëse ai nuk e pranon, e ka më të lehtë ta largojë edhe nga PS-ja. Pandeli Majkon e shikon edhe si rival për kryeministër, pasi opozita ka dërguar sinjale mirëkuptimi ministrit Majko dhe e ka shpallur si "kryeministër në hije", kur ta rrëzojnë Ramën me protesta gjatë kësaj vjeshte.

Por mësohet se do të rikthehet në qeveri ish-ministri i Financave, deputeti Anastas Angjeli. Ai mbahet mend si një

nga ministrat më profesionistë në PS. Ndërsa gjithë ministrat e tjerë do t'i propozojë nga radhët e shoqërisë civile, profesionistë si dhe që kanë afërsi shpirtërore e ideologjike me Rilindjen. Burimet thonë se vetëm Endri Fuga dhe Engjellë Agaçi, sekretar i përgjithshëm i kryeministrit, janë në dijeni të emrave që rrotullohen në tavolinën e kryeministrit. Në Ministrinë e Diasporës do të sjellë një shqiptaro-amerikan nga Nju Jorku, të cilin e ka takuar gjatë vizitave në ShBA. Në krye të Ministrisë së Kulturës përflitet emri i një aktori të njohur që javët e fun-

dit ka kaluar me kampin e Erion Veliajt për çështjen e shumëpërfolur të godinës së Teatrit Kombëtar. Emërimi i tij do jetë edhe për sfidë ndaj pjesës tjetër të artistëve, të cilët protestojnë dhe nuk tërhiqen nga kërkesat e tyre për ruajtjen e godinës historike. Te Ministria e Arsimit vjen një ish-studente që ka mbaruar studimet në Universitetin e Harvardit në ShBA. Ndërkaq ministri i Brendshëm mbetet i blinduar në Qeveri, aq më tepër që pala amerikane dhe ajo gjermane duken stoike në raport me ministrin Xhafaj.

Ahmeti: Shqiptarëve në Maqedoni s'u duhen më shumë se dy parti

SHKUP, 15 KORRIK - Lideri i Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI), Ali Ahmeti, tha se ekzistenca e më shumë se dy partive politike në Maqedoni dëmton shqiptarët e këtushëm. Ai u shpreh se partitë politike nuk duhet të bëjnë garë për të bërë marketing ditor, për të treguar se sa është patriot e kombëtar njëri apo tjetri. "Shqiptarëve në Maqedoni nuk u duhen më shumë se dy parti politike. E them me përgjegjësinë më të lartë, sepse ekzistenca e dy e më shumë partive politike në

Maqedoni dëmton shqiptarët, bëhen shqiptarët të parëndësishëm. Partitë politike të mos shndërrohen si garë për të bërë marketing ditor se, sa është patriot e kombëtar njëri apo tjetri. Ekzistenca e më shumë se dy partive politike është në dëm të shqiptarëve të Republikës së Maqedonisë", theksoi Ahmeti. Sipas tij, në zgjedhjet e fundit parlamentare shqiptarët kanë humbur 10 mandate, nuk ka humbur BDI-ja. "Dhjetë mandate nuk i fitoi askush, dmth. shqiptarët në mandatin që lamë

pas i kishin 28 mandate, sot i kemi 20 mandate dhe realisht duhet të kishim 30 mandate, ne kemi 20 mandate nga 6 parti politike që morën pjesë në garë. Kjo është një praktikë e keqe. E njëjta praktikë është instaluar në Mal të Zi dhe në Luginë të Preshevës. Nuk kanë nevojë shqiptarët as në Mal të Zi as në Luginë të Preshevës të kenë nga 9 parti politike. Ky është vullnet i njerëzve të ndryshëm që gjejnë përkrahës dhe nuk është vështirë të bësh një parti politike", theksoi kreu i BDI-së, Ahmeti.



Kosova në pritje të rekomandimit të Komisionit Evropian për liberalizim të vizave

Java e liberalizimit të vizave



Hoxha. Ajo nuk beson se çështja e migrimit në BE-së do të sjellë ndonjë problem për Kosovën. "Debatë që po zhvillohet në vendet anëtare të BE-së për migrimin patjetër se është një çështje shumë e rëndësishme për këto vende. Ne i kuptojmë shqetësimet e tyre, por Kosova është shtet i sigurt i origjinës dhe ne kemi punuar shumë dhe kemi legjislacionin sipas praktikave më të mira të vendeve të BE-së, institucione të kualifikuara për zbatimin e legjislacionit si dhe fushatat vetëdijësuese kundër migrimit ilegal duke e penguar me mjete ligjore", ka thënë Hoxha, duke shtuar se perceptimi i vendeve të BE-së për Kosovën ka ndryshuar për të mirë. "Tashmë kjo dukuri e perceptimit negativ ndaj vendit tonë është ndaluar. Kosova ka arritur ta vë në kontroll migrimin dhe kemi statistikat më të ulëta jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë", është shprehur ajo.

Udhëheqësit e institucioneve të Republikës së Kosovës, presidenti Hashim Thaçi, kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj, dhe zëvendëskryeministrat Behgjet Pacolli, Fatmir Limaj e Dardan Gashi këtë të mërkurë në Bruksel do ta takojnë përfaqësuesen e lartë të Bashkimit Evropian, Frederica Mogherini, ku do të diskutojnë edhe për çështjen e liberalizimit të vizave. "Institucionet e vendit kanë takime të përditshme për detyra shtetërore. Është me rëndësi që gjatë kësaj jave, si kërër të shtetit, të shkojmë në Bruksel në një takim të lartë me përfaqësues të BE-së, që aë konfirmojmë vullnetin dhe vendosmërinë e vendit tonë për dialogun me Serbinë dhe për liberalizimin e vizave dhe tema të tjera të rëndësishme për Kosovën", ka sqaruar zëvendëskryeministri Fatmir Limaj për takimin që kërër të shtetit do ta kenë në Bruksel.

Qeveria ka bërë me dije se pas rekomandimit pozitiv të Komisionit Evropian, Ministria e Integrimit Evropian do të nisë një fushatë për t'ua shpjeguar qytetarëve rregullat që duhet t'u përbahen gjatë këtij procesi, duke mos lejuar keqpërdorimin e liberalizimit të vizave.

Më në fund, Komisioni Evropian pritet që këtë javë ta japë rekomandimin për liberalizimin e vizave për Kosovën. Udhëheqësit shtetërorë kanë bërë me dije se rekomandimi i Komisionit Evropian për Parlamentin dhe Këshillin e BE-së rreth kësaj çështje do të ndodhë më 17 ose 18 korrik. Ata janë shprehur të bindur se rekomandimi do të jetë pozitiv, duke u zotuar se Kosova do të jetë mjaft e kujdesshme në këtë proces

liberalizimit të vizave është proces i rëndë. Duhet të jemi të kujdesshëm deri në cak. Nuk besoj se këtu humbet dikush. Nuk është meritë e kësaj Qeverie, por e një procesi të gjatë. Do ta kemi një vendim pozitiv, por nuk është kryer puna aty", është shprehur Haradinaj.

Teksa ka folur edhe për projektrezolutën e iniciuar nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e cila kërkon ndërprerjen e bisedimeve me Serbinë deri në liberalizimin e vizave, Haradinaj ka thënë se nuk do të ketë nevojë të vijë fare deri këtu. "Është vendim i grupit parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) për të cilin më kanë informuar që do ta bëjmë. Unë e respektoj. Kosova është për dialog. Edhe AAK-ja është për dialog, por shqetësimi për liberalizimin e vizave po rritet. Gjithashtu, po rritet edhe pre-

sioni mbi gjithë ne. Kjo iniciativë flet për atë presion. Nuk mendoj se do të kemi nevojë të mbërrijmë deri aty për shkak se pritet që më 17 apo më 18 korrik ta kemi edhe vlerësimin e Komisionit Evropian, që besoj se do të jetë pozitiv, pastaj do të kalojmë në etapat implementuese", ka theksuar Haradinaj.

Edhe ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, është shprehur e bindur se rekomandimi i Komisionit Evropian për liberalizim të vizave do të jetë pozitiv. "Presim rekomandim pozitiv ngaqë Kosova ka punuar për plotësimin e kriterëve. Tani presim të ketë një vendim para pushimeve të verës. Ne si institucione jemi të përkushtuar dhe të angazhuar që reformat e agjendës së integrimit evropian të vazhdojnë dhe të përshpejtohen pavarësisht prej procesit të liberalizimit të vizave", ka thënë

vendimmarrës në BE për këtë çështje do të fillojë më 17 ose 18 korrik. "Presim që më 17 apo më 18 korrik do ta kemi vlerësimin e Bashkimit Evropian për vizat i cili do të jetë pozitiv", ka deklaruar Haradinaj javën që lamë pas.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se heqja e vizave nuk do të jetë meritë vetëm e kësaj Qeverie, por edhe e atyre paraprake. Sipas tij, edhe pse rekomandimi do të jetë pozitiv, ende nuk është kryer e gjithë puna. "Procesi i

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 15 KORRIK - Komisioni Evropian pritet që këtë javë ta rikonfirmojë propozimin për liberalizim të vizave për Kosovën. Udhëheqësit qeveritarë janë shprehur të bindur se rekomandimi i komisionit do të jetë pozitiv, teksa janë zotuar se Kosova do të respektojë çdo procedurë që del nga ky proces. Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se procesi

Sot varroset kapiteni Sejdi Krasniqi

PRIZREN, 15 KORRIK (ER) - Të dielën ka ndërruar jetë kapiten Sejdi Krasniqi, komandant i Njësisë së Çminimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). "Njoftojmë të gjithë pjesëtarët e FSK-së dhe të MFSK-së, se nga

një sëmundje e rëndë, më 15. 7. 2018, ka ndërruar jetë kapiten Sejdi Krasniqi, komandant i Njësisë së Çminimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së. Ceremonia e varrimit bëhet më 16 korrik sipas agjendës në vijim: 10:00 - 11:00 do të bëhen

homazhe në kazermën e FSK-së në Prizren, në orën 12:00 do të mbahet akademja përkujtimore në Shtëpinë e Kulturës në Prizren, ndërkaq varrimi do të bëhet në orën 13:30 në Landovicë të Prizrenit", është bërë me dije në njoftimin e FSK-së.



Flet për "Epokën e re", Muharrem Nitaj

Partnerët e koalicionit qeverisës

- Është e një
rëndësie jetike
që Kosova në
Bruksel të shkojë
me një zë



Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka bërë me dije se koalicioni qeverisës është unik sa i përket dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se partnerët qeveritarë po angazhohen për arritjen e konsensusit për këtë proces, pjesë e të cilit shpreson se do të jenë shumica e partive opozitare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka theksuar se për AAK-në është jetike të ketë një konsensus politik jo vetëm për udhëheqësin e bisedimeve, por edhe për platformën dhe për strategjinë, ose qasjen që do ta ketë Kosova në këtë proces. Sa i përket funksionimit të Kuvendit, Nitaj ka deklaruar se koalicioni qeverisës nuk do ta ketë problem çështjen e numrave dhe të fuqisë për të vepruar

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 15 KORRIK - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka thënë të dielën se gjasat janë të mira për arritjen e konsensusit për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka shprehur optimizëm se shumica e subjekteve opozitare do të jenë pjesë e këtij procesi. "Gjasat janë të mira. Është e mundur që në këtë proces të

mos dojë të përfshihet ndonjë parti politike, por shpresoj se shumica do të jenë pjesë e tij. Në këtë fazë të gjithë po 'luajnë politikë', por unë besoj se LDK-ja nuk do t'i bllokojë këto bisedime. Edhe ajo ka përgjegjësi para elektoratit të vet dhe në procesin për të cilin po flasim, nuk vendoset për parti e interesa politike të askujt, por për interesa të vendit. Këtë e di edhe LDK-ja dhe shpresoj se do të jetë pjesë e tij. Më shumë nuk kam të drejtë të flas në emër të saj", ka deklaruar Nitaj. Ai ka theksuar se për AAK-në është jetike të ketë një konsen-

sus politik jo vetëm për udhëheqësin e bisedimeve, por edhe për platformën dhe për strategjinë, ose qasjen që do ta ketë Kosova në këtë proces. Në këtë kontekst, Nitaj ka bërë me dije se koalicioni qeverisës është unik sa i përket dialogut me Serbinë. "Aq sa di unë, janë unikë. E di se bashkërisht po provojnë të sigurojnë një konsensus për këtë proces. Kam përshtypjen se edhe partitë opozitare nuk janë larg. Është kuptuar rëndësia e këtij procesi dhe tashmë të gjithë e dinë se ky proces mund të jetë më i rëndësishmi në, bile, 10 vjetet e

isës janë unikë për dialogun



mërinë e Qeverisë, por me përmbajtjen e bisedimeve. Procesi final i dialogut me Serbinë ka një objektivë, që të arrihet një marrëveshje obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Çështja e të drejtave të shqiptarëve, që janë jashtë kufijve të Kosovës, duhet të jetë në agjendën e përhershme të Prishtinës dhe të Tiranës jo vetëm për Luginën e Preshevës, por edhe për shqiptarët që jetojnë në Maqedoni apo Mal të Zi. Në këtë sens ata gjithmonë do të jenë pjesë e kësaj agjende", ka thënë ai.

Në këtë intervistë Nitaj ka folur edhe për funksionimin e koalicionit qeverisës, duke thënë se Qeveria nuk do ta ketë problem çështjen e numrave dhe të fuqisë për të vepruar. "Është e vërtetë që shumica nuk i ka numrat 'komodë', por deri më tani ka funksionuar mirë. Janë kaluar shumë ligje edhe me 2/3 e votave. Besoj se 'çështja e numrave' nuk do të paraqesë problem as në të ardhmen. Ndërsa sa i përket pyetjes suaj hipotetike, se a mund ta çojë deri në fund mandatin kjo Qeveri, atë nuk e di. Në këtë vend edhe qeveritë me mbi 80 vota kanë rënë, por në anën tjetër edhe qeveritë pa numrin minimal të votave kanë funksionuar. Ne jemi vend i çuditshëm. Kurrë nuk mund ta parashohësh stabilitetin e një qeverie. Këtu qeveritë kurrë nuk kanë rënë për shkak të numrave, por për shkak të pafuqisë për të vepruar. Kjo Qeveri njëherë përnjëherë nuk e ka atë problem", ka theksuar Nitaj.

"Epoka e re": Z. Nitaj, koalicioni qeverisës, partnerët e tij, a janë unikë për procesin e dialogut?
Nitaj: Aq sa di, janë unikë. E di që bashkërisht po provojnë të sigurojnë një konsensus për këtë proces. Kam përshtypjen se edhe partitë opozitare nuk janë larg. Është kuptuar rëndësia e këtij procesi dhe tashmë të gjithë e dinë se ky proces mund të jetë më i rëndësishmi në, bile, 10 vjetët e fundit, prandaj është e një rëndësie jetike që Kosova në Bruksel të shkojë me një zë. Opozita ka interesat e veta politike, por nuk besoj t'i shpërfaqë në këtë proces që u takon të gjithëve dhe jo vetëm shumicës.

"Epoka e re": A është problematike për AAK-në udhëheqja e dialogut nga presidenti Hashim Thaçi?
Nitaj: Për AAK-në është jetike të ketë një konsensus politik jo vetëm për udhëheqësin e bised-

imeve, por edhe për platformën dhe për strategjinë ose qasjen që do ta ketë Kosova në këtë proces. Natyrisht, është me rëndësi shumë të madhe që ekipi negociator të jetë gjithëpërfshirës. Ne nuk e kemi fare problem se kush do të jetë udhëheqësi i ekipit. Mund të jetë kushdo, qoftë presidenti, qoftë dikush nga shumica parlamentare, apo edhe nga opozita. Mjafton që për këtë të ketë pajtim.

"Epoka e re": Si e shihni mosgatishmërinë e opozitës, në veçanti të LDK-së, për të mos u bërë pjesë e procesit të dialogut në fazën finale?
Nitaj: Unë nuk e kam atë përshtypje. Në këtë fazë të gjithë po 'luajnë politikë', por unë besoj se LDK-ja nuk do t'i bllokojë këto bisedime. Edhe ajo ka përgjegjësi para elektoratit të vet dhe në procesin për të cilin po flasim, nuk vendoset për parti e interesa politike të askujt, por për interesa të vendit. Këtë e di edhe LDK-ja. Unë shpresoj se ajo do të jetë pjesë e tij. Më shumë unë nuk kam të drejtë të flas në emër të saj.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh rrethanat aktuale, a mund të arrihet konsensusi dhe të formohet grupi i unitetit për këtë proces?
Nitaj: Gjasat janë të mira. Është e mundur që në këtë proces të mos dojë të përfshihet ndonjë parti politike, por shpresoj se shumica do të jenë pjesë e tij.

"Epoka e re": Kuvendi i Kosovës është duke funksionuar me vështirësi. Vetëm në seancat e fundit disa projektligje nuk ka arritur të votohen për shkak se opozita është duke pamundësuar kuorumin gjatë vendimmarrjes. Në rrethana të tilla, sa mund jetë funksional koalicioni qeverisës dhe a mund ta çojë deri në fund mandatin?
Nitaj: Nuk është se disa projektligje nuk janë votuar vetëm për shkak të opozitës, por edhe të shumicës. Ka rastisur që disa deputetë të shumicës kanë qenë në udhëtime zyrtare dhe s'kanë mundur të votojnë. Është e vërtetë se shumica nuk i ka numrat 'komodë', por deri më tani ka funksionuar mirë. Janë kaluar shumë ligje edhe me 2/3 e votave. Unë besoj se 'çështja e numrave' nuk do të paraqesë problem as në të ardhmen. Ndërsa sa i përket pyetjes suaj hipotetike, se a mund ta çojë deri në fund mandatin kjo Qeveri, atë nuk e di. Në këtë vend edhe qeveritë me

mbi 80 vota kanë rënë, por edhe qeveritë pa numrin minimal të votave kanë funksionuar. Ne jemi vend i çuditshëm. Kurrë nuk mund ta parashohësh stabilitetin e një qeverie. Këtu qeveritë kurrë nuk kanë rënë për shkak të numrave, por për shkak të pafuqisë për të vepruar. Kjo qeveri njëherë përnjëherë nuk e ka atë problem.

"Epoka e re": Z. Nitaj, liderët shqiptarë të Luginës së Preshevës edhe një herë kanë kërkuar që të drejtat dhe interesat e tyre të bëhen pjesë e dialogut Kosovë - Serbi. A është e gatshme kjo Qeveri dhe kjo klasë politike të realizojë këtë

kërkesë?
Nitaj: Ata kanë të drejtë të kërkojnë, por nuk besoj se kjo do të mund të realizohet në këtë fazë. Kjo s'ka të bëjë me gatishmërinë e Qeverisë, por me përmbajtjen e bisedimeve. Procesi final i dialogut me Serbinë ka një objektivë: që të arrihet një marrëveshje obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Çështja e të drejtave të shqiptarëve, që janë jashtë kufijve të Kosovës, duhet të jetë në agjendën e përhershme të Prishtinës dhe të Tiranës jo vetëm për Luginën e Preshevës, por edhe për shqiptarët që jetojnë në Maqedoni apo Mal të Zi. Në këtë sens ata gjithmonë do të jenë pjesë e kësaj agjende.

Vazhdon ndërtimi i murit tek ura e Ibrit në Mitrovicë

MITROVICË, 15 KORRIK - Punimet për ndërtimin e murit në pjesën veriore të urës së Ibrit në Mitrovicë kanë vazhduar edhe gjatë ditës së diel. Muri që po vendoset në rrugën "Kolashinska", afër Sheshit "Kral Petar", me gjerësi rreth 50 metra, do të jetë i gjatë 37.5 metra, ndërsa lartësia e tij do të ndryshojë prej 40 deri në 70 centimetra. Në mes të dy mureve të betonit do të krijohet hapësirë prej rreth 50 centimetra e cila do të shërbejë për mbjelljen e luleve. Po në një perimetër prej 9 metrash nuk do të ketë mur, por do të vendosen shtylla lëvizëse që, në rast nevojë, të mundësojnë qarkullimin e automjeteve me emergjencë. Një pjesë e këtij muri është betonuar të shtunën, pjesa tjetër ka vazhduar të dielën,

ndërsa përfundimi i murit me beton do të realizohet sot (e hënë). Punimet për ndërtimin e këtij muri, siç e quajnë banorët në veri "shkallë që lidhë unazën me zonën e këmbësorëve", është duke i kryer Kompania "Rad" nga Zveçani, pronar i së cilës është Rade Steviq. Revitalizimi i urës së Ibrit financohet nga BE-ja, ndërsa punimet në Sheshin "Kralj Petar" në veri, pjesë e së cilës është edhe muri, financohen nga Komuna e Mitrovicës Veriore. Vlera e tyre kap shumën rreth tre milionë euro. Zhvillimet negative kohët e fundit, të nxitura nga Serbia në Kosovë, kanë pasur për pasojë vonesat e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit, në veçanti të hapjes së urës së Ibrit e cila është dashur të ndodhë më 20 janar 2017.



DY-TRI FJALË PËR MUNDËSINË E PROCESIT TË LUSTRIMIT



Shyqyri HAXHA

Institucionet shtetformuese të Kosovës do të duhej që patjetër të iniciojnë dhe kalojnë në Kuvend Ligjin e lustrimit. Lustrimi për rrethanat shumë komplekse të Kosovës është dashur të jetë obligim kushtetues. Nëse lustrimi nuk ndodh sa më shpejt, atëherë shteti i Kosovës nuk do të mund të funksionojë, sepse në zemër të shtetit janë kuadro që nuk kanë kaluar nëpër asnjë 'filtër' që siguron qëndrueshmëri institucionale. Lustrimi nuk është akt nacionalist dhe nuk do të duhet të përdorej për hakmarrje. Lustrimi do të duhej t'i përfshinte vetëm njerëzit që do të jenë pjesë e institucioneve të ndjeshme shtetërore. Çdo shtet në botë që funksionon sot nuk lejon që njerëz me të kaluar të dyshimtë kombëtare të drejtojnë institucione shtetërore. Për disa institucione kyçe, dihet cilat janë ato institucione, do të duhet që edhe historinë e katragjyshit për t'ia zbuluar e lëre më mos të dihet asgjë për postet e tyre paraprake.

Askush nuk do të duhet t'i frikësohet lustrimit. Njerëz që ndoshta nuk do ta kalonin lustrimin, sot jo që janë në zemër të shtetit të Kosovës, dhe janë pikërisht këta njerëz që sot janë duke penguar inkuadrimitin e njerëzve dhe kuadrove që vërtet kanë histori të pastër kombëtare dhe që do ta mbronin dhe zhvillonin shtetin e Kosovës. Sot sistemi i drejtësisë dhe njerëz me histori të dyshimtë kombëtare përdoren për të njollësuar, linçuar dhe eliminuar kuadro dhe njerëz të ndershëm që babë e babagjysh me gjenerata të tëra kanë kontribuar për atë vend.

Njolllosjet e tilla kryesisht sot bëhen nga njerëz që assesi nuk do ta kalonin procesin e lustrimit. Lustrimi nuk do të duhej të përdoret për njerëz që nuk janë të inkuadruar në institucione dhe që nuk kanë të bëjnë asgjë me institucione. Çdokush ka të drejtë të punojë dhe jetojë në Kosovë, por ku janë në pyetje pozita të larta shtetërore, dhe institucione të ndjeshme shtetërore, ato patjetër duhet t'i nënshtrohen procesit të lustrimit.

Procesi i lustrimit e mbron shtetin e Kosovës. Pa lustrim nuk do të ketë shtet funksional kurrë. Kosova duhet të ndërtojë institucione që i shërbejnë shtetndërtimit, e jo institucione që u shërbejnë interesave të huaja.



Deda: Dialogu ka sukses nëse përfshihet ShBA-ja

"Pa Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në çfarëdo forme që kyçen, nuk mund të ketë sukses ky proces. Sa herë që ShBA-ja dhe BE-ja kanë qenë në një linjë apo kanë pasur një qasje unike në Ballkan, kanë pasur edhe sukses", ka thënë deputeti Ilir Deda kur është pyetur për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 15 KORRIK - Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Ilir Deda, ka bërë me dije se pa Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), në çfarëdo forme që kyçen, nuk mund të ketë sukses dialogu Kosovë - Serbi. Ai në një intervistë dhënë për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se dialogu do të kishte suksese nëse ShBA-ja përfshihet në këtë proces. "Pa Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në çfarëdo forme që kyçen, nuk mund të ketë sukses ky proces. Sa herë që ShBA-ja dhe BE-ja kanë qenë në një linjë apo kanë pasur një qasje unike në Ballkan, kanë pasur edhe sukses. Kur nuk ka pasur unitet trans-atlantik, atëherë nuk ka pasur sukses dhe unë mund ta shpreh, si Alternativë, ne jemi të zhgënjyer me rolin e zonjës

Mogherini, sidomos në këta 12 muajt e fundit karshi këtij procesi të normalizimit midis Kosovës dhe Serbisë", ka deklaruar Deda. Në pyetjen se sa është optimist se mund të arrihet një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë, Deda ka thënë se personalisht është skeptik në seriozitetin e Serbisë që ta mbërrijë këtë normalizim. "Sa është serioze udhëheqësia serbe, kur harxhon qindra miliona euro për anulimin e njohjeve të Kosovës, na lufton në arenën ndërkombëtare, përpiqet të demonizojë Kosovën, nuk lejon njerëz të artit e të kulturës të udhëtojnë në Beograd. Domethënë, një retorikë prej një pjese të Qeverisë së Serbisë, e cila është e njëjta si e viteve të '90-ta ndaj shqiptarëve të Kosovës. Ne

duhet të pyesim zonjën Mogherini dhe udhëheqësinë serbe se a jeni ju seriozë në këtë proces dhe nëse po, atëherë duhet ta ndryshoni rrënjësisht qasjen që e keni ndaj këtij procesi. Po ashtu, nuk mund të ketë marrëveshje të suksesshme nëse ne vazhdojmë të jemi në defanzivë duke u mbrojtur gjatë gjithë kohës. Për spektrin politik në Kosovë është me rëndësi që nuk duhet të preket integriteti territorial i Republikës së Kosovës. Pra, nuk mund të ketë ndarje, nuk mund të ketë shkëmbim të territoreve sepse ato janë ide të shekullit XIX dhe ne nuk duam të jetojmë në parime të tilla. Dhe, po ashtu, nuk mund të rrezikohet funksionaliteti i brendshëm i Kosovës", ka thënë deputeti Ilir Deda.

Kelmendi: LDK-ja dhe Vetëvendosja po i frikësohen Ramushit

EPOKA E RE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 15 KORRIK - Kryetari i Partisë Fjala, Gëzim Kelmendi, ka thënë se opozita, e udhëhequr nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje, nuk është po tregon vendosmëri përballë vendimeve të dëmshme të Qeverisë Haradinaj. Ai ka thënë se këto dy parti janë duke iu frikësuar kryeministrit Ramush Haradinaj. "Pozita e udhëhequr nga PAN-i dhe AKR-ja, me ndihmën e partisë opozitare, LDK-

së, e shitën tokën e Kosovës. Ia dhuruan Malit të Zi 8 000 hektarë. Krejt kjo e kishte një çmim: liberalizimin e vizave. Çka fituan? Edhe e humbën tokën e Kosovës, edhe nuk realizuan liberalizimin e vizave. Ndërsa opozita, e udhëhequr nga LDK-ja dhe LV-ja, nuk tregon vendosmëri përballë vendimeve të dëmshme të Qeverisë Haradinaj, pasi që po i frikësohen Ramushit", ka thënë Kelmendi. Ai ka shtuar se LDK-ja po dëshmon edhe një herë politikën e bazuar në frikë dhe mungesë guximi, jo të sinqertë

dhe flirtuese. "LDK-ja ishte ajo që për këta 19 vjet pas luftës mbajti të gjallë PDK-në në pushtet. Edhe Kadri Veselin si kryeparlamentar, edhe Hashim Thaçin si president e kemi dhuruar prej LDK-së. LV-ja ishte e fortë me ve dhe domate kundër ish-kryeministrit Mustafa, ndërsa përballë kryeministrit Haradinaj nuk po guxon as 'cëk' të bëjë. Në vend të vezëve dhe domateve, Ramushit po i dërgojnë propozime dhe ide me shkrim", është shprehur ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Gëzim Kelmendi.



A do të bëhet Kosova këtë vit me ushtri?

Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Burim Ramadani, është i bindur se këtë vit Kosova do ta ketë ushtrinë e vet. Sipas tij, askush nuk mund ta bllokojë këtë proces. Ndërsa ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, u ka bërë thirrje Qeverisë dhe Kuvendit që sa më shpejt me anë të ligjit t'i ndryshohet mandati FSK-së meqenëse themelimi i Forcave të Armatosura me anë të ndryshimeve kushtetuese po shihet si rrugë e pamundur

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 KORRIK - Zëvendësministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Burim Ramadani, ka thënë të dielën se askush nuk mund ta bllokojë anëtarësimin e Kosovës në NATO. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se Kosova e ka vendin në NATO dhe se viti 2018 do të jetë vit i ushtrisë. "Kosova e ka vendin në NATO. Maqedonia mbrëmë ka festuar për ftesën për anëtarësim në NATO, Mali i Zi para një viti (maj 2017), ndërsa Shqipëria e ka shënuar këtë arritje historike në vitin 2009. Kosova në tri anët e kufirit të vet ka NATO-n, kurse prania e misionit të udhëhequr nga NATO (KFOR) po përmblush dy dekada. Kosova e ka vendin në NATO, pavarësisht sa kohë është e nevojshme. Askush nuk mund t'ia bllokojë drejtimin. Një gjë është e qartë: Viti 2018 është vit i ushtrisë", ka shkruar Ramadani. Ndërsa ish-komandanti i Forcës

së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, ka paralajmëruar institucionet e Kosovës se po vonohen me formimin e ushtrisë. Ai u ka bërë thirrje Qeverisë dhe Kuvendit që sa më shpejt me anë të ligjit t'i ndryshohet mandati FSK-së meqenëse themelimi i Forcave të Armatosura me anë të ndryshimeve kushtetuese po shihet si rrugë e pamundur. "Jam shumë i bindur se ditaditës Kosova po vonohet shumë në formimin e ushtrisë. Kam thënë edhe më herët dhe po e përsëris prapë, se Qeveria, së bashku me Kuvendin e Kosovës, duhet të ecin tutje në këtë drejtim dhe të mos vonohen më. Me marrëveshje me partnerët tanë strategjikë, institucionet tona duhet të fillojnë që me anë të ligjit FSK-së t'ia ndryshojnë mandatin dhe të vazhdohet tutje me këtë proces", ka thënë Kastrati për gazetën "Epoka e re". Ai ka treguar se sa po humbet Kosova me vonesat në formimin e ushtrisë. "Kosova po humbet me këto vonesa, sepse për ta



bërë një ushtri operationale duhen rreth 10 vjet kohë. Pra, ushtria nuk mund të bëhet brenda një kohe të shkurtër. Prandaj po them që sa më herët të fillohet të veprohet në këtë drejtim është më mirë. Në këtë drejtim Kosova po humbet në aspektin e sigurisë, në aspektin e integritetit në NATO, si dhe në aspektin e integriteteve rajonale dhe anëtarësimin në mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë", ka thënë Kastrati. Ish-komandanti i FSK-së ka vlerësuar se Kosova nuk ka asnjë arsye të vonohet në këtë drejtim. Sipas tij, institucionet e Kosovës këtë vit duhet të marrin vendim për ndryshimin e mandatit të

FSK-së. Kurse në ditët e fundit mbi 40 pjesëtarë të FSK-së nga komuniteti serb kanë bërë kërkesë për largim për shkak të presioneve dhe kërcënimeve nga Serbia. Gjeneralletenant Rrahman Rama ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se largimi i pjesëtarëve serbë nga kjo forcë nuk do të ketë ndikim në transformimin e FSK-së. "Jo, nuk do të ndikojë. Ky është një proces krejtësisht i ndarë. Jemi duke i kryer obligimet dhe punët tona. Ne e kemi bërë më të mirën e mundshme duke qenë institucioni shembull në vend, por edhe për shumë vende të rajonit jemi liderë sa i përket përqindjes së komuniteteve në FSK. FSK-ja do të

vazhdojë të jetë gjithëpërfshirëse, kredibile si dhe është e gatshme ta kryejë misionin e vet. Prandaj nuk shoh se këto largime do të kenë ndonjë ndikim në tranzicionin e FSK-së", ka deklaruar ai. Ai ka treguar se ka të interesuar të tjerë dhe shumë shpejt do të plotësohet numri i të dorëhequrve. "Ka interesim të komunitetit serb për t'u bërë pjesë e FSK-së. Kemi edhe aplikues të tjerë. Do ta plotësojmë këtë numër pa asnjë problem. FSK-ja do të funksionojë me apo pa ata, me apo pa mua. FSK-ja nuk është organizatë që për 20-30 persona shuhet. FSK-ja do ta vazhdojë punën e vet", ka thënë Rama.

Ambasadori norvegjez: Të rishikohen hollësitë rreth Asociacionit

PRISHTINË, 15 KORRIK - Është eseniale të rifillohet dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, si një rrugë para, për përparimin e të dy vendeve. Derisa udhëheqja e politikës së jashtme e një shteti duhet të ketë pikënisje gjithmonë Kushtetutën e vendit, e Kushtetuta e Kosovës thotë se presidenti është lideri që duhet ta bëjë atë. Kështu ka thënë ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, Per Strand Sjaastad, në një intervistë për "Kosovpress"-in, në të cilën ka folur për situatën politike në Kosovë, përfshirë dialogun me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve, themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe, transformimin e mandatit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) si dhe liberalizimin shumëpritur të vizave.

Sipas tij, palët në dialog duhet ta shmangin llojin e sjelljes që është provokuese dhe se kjo përgjegjësi i takon Beogradit dhe Kosovës, ndryshe shanset për arritjen e marrëveshjes finale do të jenë më të vogla sesa mund të kishin qenë më parë. Më tutje, ai ka folur edhe për transformimin e mandatit të FSK-së në atë ushtarak, diçka që, sipas tij, do të ndodhë, por vështirë se mund të flitet tash për një datë se kur. I pyetur rreth Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe detyrimin që Kosova ka për të themeluar dhe funksionalizuar atë, ambasadori norvegjez ka theksuar se një shkallë e decentralizimit të kompetencave është e natyrshme në çdo vend, veçanërisht ato vende ku ka komunitet joshumicë.



Duke folur rreth çështjes së liberalizimit të vizave për Kosovën, dhe datën e mundshme kur do të

mund të ndodhë kjo, ambasadori norvegjez ka thënë se nuk është i sigurt për afatin kohor dhe nuk

mendon se është kohë e mirë të flitet për datë, por të punohet për përmblidhje të kriterëve.

Intervistë me kryetarin e ri të Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi

Kemi dështim të komunikimit publiko-pri



Kryetari i sapozgjedhur i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se ligjet e fushës ekonomike në Kosovë duhet të formulohen përmes konsultave publike dhe dialogut publiko-privat. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se në vitet e fundit ka dështim të plotë të komunikimit publiko-privat. Sa iu përket sfidave të të bërit biznes në Kosovë, Rukiqi ka përmendur tri prej tyre: informalitetin, fuqinë punëtore dhe problemet me energji elektrike

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 15 KORRIK -

"Epoka e re": Z. Rukiqi, cilat janë objektivat e juaja për mandatin që keni marrë si kryetar i OEK-ut?

Rukiqi: Ne duhet ta shohim gjendjen reale në sektorin privat dhe mundësitë që ka ekonomia jonë, natyrisht që këtë duhet shikuar barazi me atë çfarë po ndodhë në ekonomitë globale. Janë tri çështje që do të përpique-mi t'i adresojmë si Odë

Ekonomike e Kosovës. Pra, për të plotësuar një hendek që e shoqëron ekonominë dhe vendimmarrjen tonë që lidhet me mostrajtimin e duhur të ekonomisë, në veçanti të sektorit privat. Tri objektivat kryesore janë: Rritja e eksportit ose promovimi i eksportit do të ndikojë në rritjen e punësimit. Po ashtu, angazhimi ynë do të jetë se çfarë duhet të ndërmerret që të ndryshojë sistemi i edukimit në raport me nevojat e tregut të punës. Pastaj, ekonomia digjitale, pra aspektet e digjitalizimit

të ekonomisë në sektorin privat, është jo vetëm trend, por edhe nevojë, duke ditur se jemi njerëzit me penetrimin më të lartë në internet. Po ashtu, shoqërimin e mekanizmave të ndryshme që ofron ekonomia digjitale.

"Epoka e re": E përmendet harmonizimin e sistemit arsimor me atë praktik, ndërkohë u raportua se çdo i katërti student i diplomuar ka diplomë të ekonomisë. Sa ka bërë Qeveria deri më tash në këtë drejtim dhe

çfarë mendoni se duhet të ndryshojë?

Rukiqi: Sistemi arsimor dhe edukativ nuk është menaxhuar me strategji të duhur dhe në masë të madhe ka qenë faktikisht i orientuar me improvizime që, ndoshta, kanë shkaktuar qetësi sociale, në anën tjetër nuk është shikuar në periudhën afatgjatë dhe në përputhje të trendëve dhe transformimeve të ekonomive të ndryshme. Normalisht se nuk janë pa ndikim edhe tek ne, pasi s'jemi të izoluar. Po shohim se Kosova ka juristë më shumë se Roma, e cila është vendlindja e të drejtës dhe e atyre që pretendojnë për të qenë profesionistët më të mirë në këtë fushë, ndërsa ne kemi numër më të lartë se Roma jo vetëm për kokë banori, por në total. Ky është një ndër indikatorët që njerëzit kanë diploma në financa dhe menaxhment, kurse nga anën tjetër kemi

shumë kompani që kanë probleme për gjetjen e njerëzve adekuatë apo projekteve të caktuara dhe normalisht që kërkojnë fuqi punëtore të kualifikuar. Prandaj mendoj se duhet të largohet vendimmarrja që e trajton vetëm aspektin e qetësisë sociale kur vendoset sa studentë t'i pranojë, por edhe duhet të kalohet në atë që të kemi plan-programe dhe kurrikula që lidhen me nevojat e tregut të ekonomisë.

"Epoka e re": Cila është pozita e sektorit privat në Kosovë karshi atij publik, marrë parasysh edhe rritjet e vazhdueshme të pagave në sektorin publik. Së fundi pamë edhe koeficientet në Projektligjin për paga?

Rukiqi: Çështja e pagave është një nga politikat më diskriminuese dhe më të mbrapshta për shkak se ka krijuar një konkurrencë të pabarabartë. Zakonisht

vat në harmoni me interesat ekonomike



problemet e sektorit privat janë konkurrennte brendapërbrenda sektorit, por në këtë rast kemi konkurrentë të çuditshëm me sektorin publik në kuptim të pagave dhe të interesimit të njerëzve që janë të interesuar për të punuar në sektorin publik. Në raport me sektorin privat mesatarja e pagave në mes të këtyre dy sektorëve është diskriminuese.

"Epoka e re": Janë një mori projektligjesh të çështjeve ekonomike që presin rishqyrtim dhe se disa prej tyre janë zvarritur prej kohësh. Sa është e vëmendshme kjo qeverisje sa i përket sektorit privat?

Rukiqi: Nuk është çështje vetëm për të proceduar ligje, pasi janë proceduar shpesh dhe janë bërë gabim, e disa prej tyre dhe kanë qenë të kopjuara nga vendet e tjera, duke mos i marrë parasysh kështu rrethanat e tjera. Nuk jam ithtar që të ketë ligje shumë, por të jenë efikase që bëhen përmes konsultave publike dhe dialogut publiko-privat. Sidomos në vitet e fundit kemi dështim të plotë të komunikimit publiko-privat në harmoni me zbatimin e ideve, që mund t'i bëjnë ligjet më të mira dhe që i ndihmojnë sektorit privat. Ligjet duhet të bëhen në harmoni me interesat e sektorit privat dhe konsultave publike.

"Epoka e re": Cilat janë sfidat kryesore që po i adresojnë bizneset tek ju?

Rukiqi: Në vitet e fundit informaliteti, fuqia punëtore, si dhe problemet me energji elektrike janë ndër tri problemet kryesore. Bazuar në analizat tona të fundit për barrierat e të bërit biznese, sfida kryesore është informaliteti që, në masë të madhe, lidhet me konkur-

rencën jolojale në treg. Gjithashtu, ndër vite mbetet problemi më fundamental, mungesa apo jostabiliteti i furnizimit me energji elektrike. Ndërkaq sa i përket fuqisë punëtore, ne kemi mungesë të fuqisë punëtore për sektorë të caktuar siç e përmenda më herët për shkak të vëmendjes së sistemit arsimor në shkollat profesionale. Nëse e shohim sa iu përket projekteve, kemi pasur projekte madhore si ai i kogjenerimit që është dashur të importojmë saldues, pasi kemi pasur numër minimal të tyre, që është paradoks në vete. Kemi papunësi të lartë në Kosovë. Nuk kemi profesionistë të një fushe. Po ashtu, kemi edhe projektin "Kosova e re" që kërkon punëtorë të specifikuar si saldues, kurse ne kemi mungesë të tyre.

"Epoka e re": Z. Rukiqi, cili do të jetë roli i OEK-ut sa iu përket bizneseve nga diaspora?

Rukiqi: Duke parë dje shembullin e vendeve të tjera se si ka ndikuar ikja e njerëzve jashtë vendit, mendojmë se te ne ka pasur aspekte pozitive, sepse diaspora është financuesja kryesore e konsumit apo e asaj që mbetet si hendek nga defici- ti tregtar. Tash është koha për avancim të këtyre relacioneve. Ne duhet ta shfrytëzojmë tani kapitalin e tyre human, në të njëjtën kohë ta shfrytëzojmë edhe atë financiar, në mënyrë që ata ta kenë komoditetin për investime në vendin e tyre, që është e domosdoshme. Kemi shumë raste të bizneseve inova- tive dhe prodhuese që përmes lidhjes që kanë krijuar me dias- porën mund të sjellin brende të njohura këtu, të cilët do të ndikonin edhe në ngritje të eksportit.

Lekaj: Së shpejti Kosova bëhet me pilotë të aviacionit civil

PRISHTINË, 15 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, dhe homologu i tij nga Katari, Jassim Bin Saif Al-Sulaiti, kanë nënshkruar marrëveshjen e shërbimeve ajrore, e cila u hapë rrugë fluturimeve të drejtpërdrejta të "Qatar Airways" ndërmjet Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP) "Adem Jashari" dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Dohasit. Lekaj nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook" ka bërë me dije se shumë shpejt Kosova do të bëhet me pilotë të aviacionit civil. "Në Doha të Shtetit të Katarit nënshkrova marrëveshjen e shërbimeve ajrore me homologun, Sh. T. Jassim Bin Saif Al-Sulaiti. Kjo marrëveshje hap rrugën për fluturimet e drejtpërdrejta të 'Qatar Airways' midis ANP 'Adem

Jashari' dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Dohas. 'Qatar Airways' tash e disa vjet është zgjedhur kompania më e mirë në botë", ka shkruar Lekaj. Ai ka thënë se ministrin Al-Sulaiti e ka njoftuar për zhvillimet infrastrukturore në rrugë, në transportin ajror, atë hekurudhor, si dhe për projektet strategjike në të ardhmen. "Nga ministri Al-Sulaiti pranova gatishmërinë e Shtetit të Katarit për përkrahjen e Republikës së Kosovës në këtë drejtim. Përkrahje nga shteti i Katarit kërkova për shkollimin e pilotëve nga Kosova dhe stafit tjetër deficitar të aviacionit në Kolegjin Aeronautik të Katarit, i cili ka famë botërore. Edhe në këtë drejtim ministri Al-Sulaiti u zotua që studentët e përzgjedhur nga Kosova për pilotë dhe profe-



sione të tjera në fushën e aviacionit do të shkollohen në këtë kolegji, me bursë të plotë nga shteti i Katarit. Për këtë, së shpejti do të nënshkruhet një mar-


rëveshje e veçantë midis dy ministrive", ka bërë me dije ministri Lekaj. Lekaj ka theksuar se janë pajtuar që menaxhmenti i "Qatar

Airways" të vijë së shpejti në Prishtinë për të bërë një studim fizibiliteti me qëllim të fillimit të fluturimeve të drejtpërdrejta midis Dohas dhe Prishtinës.

Nis asfaltimi i rrugës në fshatin Gaçkë të Ferizajt

FERIZAJ, 15 KORRIK (ER) - Banorët e fshatit Gaçkë i janë gëzuar shumë asfaltimit të rrugës kryesore dhe rrugicave në këtë fshat. Ata janë shprehur tejet mirënjohës ndaj Komunës së Ferizajt, e cila po bën rregullimin e infrastrukturës rrugore. Punimet në këtë rrugë i ka përcjellë nga afër edhe drejtori i Infrastrukturës, Arbër Bytyqi, së bashku me mbikëqyrësit e këtij projekti. Ai ka theksuar se cilësia e punimeve në asfaltimin e

rrugës kryesore dhe rrugicave në fshatin Gaçkë është më e mirë sesa në vitet e kaluara. "Cilësia e punimeve në rrugët e fshatit Gaçkë është shumë e mirë sesa në vitet e kaluara. Kjo rrugë ka një shtresë të asfaltimit, ndërsa sot po e bëjmë edhe shtresën e dytë, por po shihet se cilësia është e standardeve shumë më të larta", ka thënë Bytyqi. Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gaçkë ka një kosto prej 244 mijë eurosh, ndërsa gjatësia e tyre është afër tri kilometra.



Zbulohet lapidari i Kamer dhe Murat Loshit

SKENDERAJ, 15 KORRIK (ER) - Në Komunën e Skenderajt është ngritur lapidari i luftëtarëve Kamer dhe Murat Loshi në fshatin Pemishtë të kësaj komune. Në ceremoninë e inaugurimit të këtij lapidari kanë marrë pjesë kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, i cili ishte i shoqëruar edhe nga nënkryetari Nuredin Lushtaku, kryesuesja e Kuvendit Komunal, Fatbardha Haliti dhe drejtorët komunalë.

Po në këtë aktivitet kanë marrë pjesë edhe kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, deputeti Bekim Haxhiu, deputeti i Kuvendit të Maqedonisë, Zijadin Sela, ish-kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku, përfaqësues të institucioneve lokale, qendrore dhe qytetarë të shumtë. Zbulimi i lapidarit në fjalë është bërë nga kryetari Jashari dhe deputeti Sela. Me këtë rast, kryetari i Skenderajt, Bekim

Jashari, ka thënë se ky lapidar ishte i nevojshëm. "Jemi këtu në ceremoninë e përvitë të lapidarit të dëshmorëve Loshi, që ranë një shekull më parë. Ky lapidar është i nevojshëm që t'i përkujtojmë sakrificat për lirinë e vendit tonë", është shprehur Jashari. Lapidari është ngritur në shenjë nderimi për dy dëshmorët që janë vrarë nga forcat serbe, Kamer Loshi, në vitin 1924 si dhe Murat Loshi në vitin 1974.



178 mësimdhënës të Malishevës ndoqën trajnimet për korrikulën e re

MALISHEVË, 15 KORRIK (ER) - Ka përfunduar procesi i trajnimeve në të gjitha fushat kurrikulare për vitin 2018-2019, dedikuar për mësimdhënësit në Komunën e Malishevës. Ky proces është realizuar në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe të gjitha institucionet relevante të sistemit arsimor. Sipas koordina-

torit për kurrikulë në Komunën e Malishevës, Halim Hoti, procesin e trajnimit e kanë ndjekur 178 mësimdhënës. "Fushat e kurrikulës të cilat mësimdhënësit realizuan trajnimet janë: gjuhët dhe komunikimi, matematikë, shkencat e natyrës, shoqëria dhe mjedisi, programi klasor dhe klasa parafillore, jeta dhe puna - TIK", ka thënë Hoti.

Ai ka shtuar se mësimdhënësit kanë treguar interesim të madh dhe ishin shumë të përgjegjshëm. "Gjithashtu, procesin e trajnimit e realizuan trajnerët për secilën fushë kurrikulare, të cilët bashkëpunuan ngushtë me Drejtorinë e Arsimit dhe realizuan me përgjegjësi programin e trajnimit", ka deklaruar Hoti.

Mot me diell dhe vranësira në pesë ditët e ardhshme

PRISHTINË, 15 KORRIK (ER) - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) ka njoftuar se në pesë ditët e ardhshme vendi ynë do të jetë nën ndikimin e masave të ngrohja të ajrit me origjinë nga verilindja. "Në këto kushte do të mbajë mot me diell dhe vranësira të cilat ditën e hënë, të martën dhe të enjten do të shoqërohen me reshje

shiu. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 15-17 gradë celsius, ndërsa temperaturat maksimale të ditës do të lëvizin ndërmjet 27-30 gradë celsius. Shtypja atmosferike do të ketë luhatje duke regjistruar edhe vlera nën normalen. Do të fryjë erë kryesisht nga verilindja me shpejtësi deri 11m/s", ka njoftuar IHMK-ja.



PROBLEME THEMELORE TË PUNIMEVE STUDIMORE (10)



Hajdin ABAZI

15. Përfundimi duhet t'i korrespondojë hyrjes

Kjo që u tha më sipër lidhet drejtpërdrejt me atë që është bërë traditë nëpër universitetet tona: qasjen për të shkruar punime studimore. Në kuptimin që, kur në "hyrje" janë parashtruar qëllimi, objektivat, pyetjet studimore dhe hipotezat, dhe përgjatë studimit, nëpër kapituj e nënkapituj, zhvillohet studimi i palidhur me këto aspekte, atëherë të paktën në fund, për të bërë një përmbyllje logjike, do të duhej të tregohet se cili është rezultati për hipotezat, pyetjet studimore, objektivat dhe qëllimin.

Sigurisht, sikurse u tha, ka modele të ndryshme se si mund të realizohet një studim, dhe se si mund të ndërlihen aspektet studimore. Po qe se, fjala vjen, në secilin kapitull është shtjelluar rrjedha e studimit për hipotezën përkatëse, ose/edhe për pyetjen përkatëse studimore dhe objektivin që i korrespondon dy të parave, atëherë, po, në fund të studimit, në "përfundim" do të mund të sintetizohet e tëra rreth qëllimit dhe asaj se çfarë është mësuar më shumë nga studimi për temën e trajtuar.

Krejt në fund, dua të nënvizoj se ajo që duhet mbajtur parasysh gjatë realizimit të një studimi, sidomos kur ai të përgatitet si formë finale për publikim apo paraqitje për mbrojtje, është se të gjitha ato që janë parashtruar në "hyrje" ose duhet të përmbahen brenda kapitujve të studimit, ose të paktën bile në "përfundim" të bëhet një përmbledhje e arritjeve në raport me ato që janë parashtruar në "hyrje", për t'i saktësuar rezultatet.

Meqë këtu u nënvizuan disa probleme, tregon një gjendje të tanishme, e cila përmban potencial intelektual dhe përvojë për të bërë shkencë në mënyrë më të mirëfilltë, ka për synim shenjëstrimin e tyre ashtu që ato të kuptohen dhe të tejkalohen. Është lajthitje e pakëndshme ta bindim veten se po bëjmë shkencë në nivel bashkëkohor, ndërkohë në shumicën e punimeve studimore të manifestohen gabime elementare, çalime metodologjike dhe parregullsia në konstituimin e rezultateve.

VI. DISKUTIMI SI SHQYRTIM KRITIK

E tëra që u tha deri këtu nuk do të

ishte e mjaftueshme po qe se nuk ngritët edhe një çështje, e cila është themelore dhe duhet t'i kushtohet vëmendje e duhur.

Punimeve të shumta studimore, në masë të madhe, ju mungon ajo që quhet "diskutimi". Këtu e dhjetë vjet më parë, në librin tim "Hyrye në shkrimin akademik" kam avokuar që në çdo punim që pretendon të jetë studimor, të inkorporohet gjithsesi një pjesë e cila të bëjë me diskutimin e atyre që janë shkruar, pohuar dhe gjetjeve. Por, ajo që aktualisht bie në sy bënë të qartë se nuk është nxitur një qasje e këtille për çka edhe shumica e punimeve që pretendojnë të jenë studimore e kanë këtë mangësi.

Do të përpiqem ta riaktualizojë këtë nevojë, dhe të tregoj se përse ajo duhet të jetë pjesë integrale e çdo punimi që pretendon të jetë studimor.

1. Ku në punim mund të bëhet diskutimi?

Çka është "diskutimi" në një punim?

Shprehur shkurtimisht, "diskutimi" është një shoshtje e asaj që është thënë nga autorë apo burime të ndryshme, nga gjetje apo fakte të ndryshme, si një punë përgatitore për të kristalizuar arritjet e studimit.

Është ose duhet të jetë një pjesë e çdo studimi. Nuk ka ndonjë kriter se ku saktësisht duhet të zhvillohet kjo pjesë. Ajo mund të bëhet në çdo kapitull, për shembull, në një nënkapitull të veçantë; ose ajo mund të bëhet në një kapitull më vete, zakonisht në kapitullin e parafundit të një punimi. Në rastin e parë, po qe se diskutimi bëhet brenda një kapitulli, atëherë karakteri i diskutimit përfshinë vetëm pjesën që është shkruar deri te diskutimi, pra vetëm atë kapitull. Kurse po qe se diskutimi bëhet në kapitullin e parafundit, atëherë ai përfshin gjithë ato që janë thënë nëpër kapitujt e tjerë, deri te diskutimi. Po qe se diskutimi bëhet në një kapitull më vete, kapitulli i fundit para "përfundimit", atëherë ajo është një punë përgatitore tërësore e rezultateve finale, që pason menjëherë në kapitullin e radhës "përfundime".

Po qe se diskutimet bëhen në secilin kapitull, atëherë ato janë pjesë fragmentare që shoshtin aspektet që lidhen me studimin në kapitullin përkatës, dhe kështu, pastaj, në "përfundim" bëhet sintetizimi i tyre, duke referuar kapitujt përkatës, në rezultatet e studimit.

2. Kur dhe çfarë duhet bërë në një diskutim?

Çka konkretisht duhet bërë gjatë "diskutimit"?

Për të krijuar një pasqyrë më të qartë, le të supozohet se një kapitull i ka pesë nënkapituj Në nënkapitullin e parë është

bërë prezantimi i problematikës me të cilën do të rreket studimi në këtë kapitull. Nënkapitulli i dytë prezanton kornizën teorike të problematikës. Nënkapitulli i tretë paraqet pikëpamjet për dhe kundër, përkatësisht argumentet dhe kundërgargumentet. Nënkapitulli i katërt prezanton gjetje, për shembull, nga hulumtimi i bërë enkas për këtë problematikë. Të gjitha këto nuk janë të mjaftueshme dhe të vetëkuptueshme, sepse kanë nevojë për një qartësim. Nëse deri këtu autori ka qenë prezent si hije, këtu ai duhet të dal në dritë, të shfaqet. Ai duhet të ndërhyjë, përkatësisht të paraqes mendimin e vet lidhur me pikëpamjet për e kundër, argumentet e kundërgargumentet, për karakterin e gjetjeve nga studimi. Studiuesi këtu duhet të tregojë pse qëndron pikëpamja për ose kundër, pse është i pranueshëm argumenti e jo kundër-argumenti, dhe se çka sugjerojnë gjetjet.

3. Diskutimi duhet ta prekë thelbin e problemit studimor

E lehtë është të thuhet por mjaft e vështirë të bëhet "diskutimi", pasi që ai duhet të prekë thelbin e problemit, të mendimeve, pikëpamjeve, argumenteve dhe të gjetjeve. Kjo domethënë se studiuesi duhet të shkojë përtej asaj që kanë thënë të tjerët, duhet t'i gjykojë ato, t'i vlerësojë dhe të mbajë qëndrim për secilën. Me fjalë të tjera, studiuesi duhet të bëjë një shqyrtim kritik.

Shqyrtim kritik domethënë qasje me paanshmëri, e mbështetur dhe duke kërkuar mangësi përmbajtjesore ose mungesë të dhënash lidhur me pikëpamjet për ose kundër, argumentet ose kundër argumentet.

Për fat të keq në pjesën dërmuese të punimeve studimore mungon një qasje e këtille kritike, një shqyrtim që hedh dritë më shumë në ato që janë thënë në nënkapitujt ose kapitujt paraprak, apo që hedhë poshtë pjesërisht ose tërësisht një pikëpamje për a kundër, një argument apo kundër-argument.

Pa fije dyshimi se është e zorshme të kritikohet mendimi i ndonjë shkencëtari, sepse në pikëpamjet e shprehura për ose kundër, ka argumentuar apo kundërgargumentuar dhe ka pas parasysh se duhet të jetë formulim i duhur, i mbështetur dhe i qëndrueshëm, sepse do të shqyrtohet në mënyrë kritike nga të tjerët dhe është munduar që ta bëjë atë që ka shkruar të parrëzueshme.

4. Shqyrtimi duhet të hedhë dritë mbi të vërtetën

Si pikënisje mund të jetë fakti se zakonisht nuk mund të jenë të

vërteta njëlloj si pikëpamja për ashtu edhe pikëpamja kundër, si argumenti ashtu edhe kundër-argumenti. Sidomos në kontekstin kur secila syresh, si pikëpamja për ashtu edhe ajo kundër, si argumenti edhe kundër-argumenti pretendojnë të jenë të vërteta, gjë që nuk mund të jenë të vërteta që të dyja, por njëra nga to. Nuk domethënë se vetëm pikëpamja për mund të jetë e vërtetë, po aq ka gjasa të jetë e tillë edhe pikëpamja kundër; dhe e njëjta vlen për argumentin dhe kundër-argumentin. Studiuesi është ai i cili, në kontekstin e studimit të tij, duhet të mbajë anë, të përcaktohet për vërtetësinë e njërës ose tjetrës.

E për ta bërë këtë, kërkohet një shoshtje rrënjësore e kuptimit, e referencës se pikëpamjes për dhe kundër, e argumentit dhe e kundër-argumentit, të shihet fuqia e mbështetjes dhe qëndrueshmëria ose jo e saj. Kjo kërkon që studiuesi të jetë aktiv, të jetë pjesëmarrës dhe të debatojë me studiues të tjerë. Një shqyrtim i këtille, sigurisht, i tejkalon caqet deskriptive. Nëse, fjala vjen, në nënkapitujt/kapitujt paraprak mund të bëjë punë deskriptivizmi, te nënkapitulli/kapitulli i diskutimit, ai të lë në baltë. Diskutimi kërkon me domosdoshmëri të ndryshohet qasja, të përdoren të tjera teknika dhe tjera instrumente shqyrtimi, gjykimi e vlerësimi. Pikërisht kjo mungon në shumicën e rasteve në punimet studimore në nivele të ndryshme.

5. Duhet bërë publike gjetjet nga shqyrtimi kritik pa hezitim

Mendimi kritik sugjeron se duhet trajtuar në mënyrë jodiskriminuese si pikëpamjet për ashtu edhe ato kundër, si argumentet ashtu edhe kundër-argumentet, si faktet edhe kundërfaktet.

Qasja kritike nuk është qëndrim negativ, mohues, sulmues. Qasja kritike është, dhe duhet të jetë, shqyrtim i paanshëm dhe objektiv. Ai është shqyrtim për të parë gjendjen reale të një pikëpamjeje, të një argumenti apo të fakteve dhe të kundërtat e tyre, duke mos u nisur nga paragjykime apo anime paraprakisht të përcaktuara.

Nga gjetjet që bëhen përmes shqyrtimit kritik duhet të rrjedhë qëndrimi për pikëpamjen për ose kundër, për argumentin ose kundër-argumentin, për faktin ose kundërfaktin.

Le të supozohet se shqyrtimi kritik gjen mangësi në pikëpamjen për, e cila, për shembull, duket bombastike, e formuluar mirë, por referenca e saj nuk ka qëndrueshmëri ose është jo ajo e pretenduara. Atëherë, këto gjetje me korrektësi duhet t'i paraqesë studiuesi në "diskutim".

E në anën tjetër, le të supozohet

se shqyrtimi kritik nuk gjen mangësi në pikëpamjen kundër, e cila, teorikisht mund të mos duket shumë shkëlqyese por referenca e saj tregohet e qëndrueshme dhe mund të identifikohet qartë. Atëherë, këto gjetje me korrektësi duhet po ashtu t'i paraqesë studiuesi në "diskutim".

E njëjta gjë vlen edhe lidhur me argumentin dhe kundër-argumentin, për faktin apo kundërfaktin. Ato duhet shqyrtuar ashtu që të jetë si një testim i qëndrueshmërisë së tyre, i konsistencës logjike, i koherencës përmbajtjesore dhe i përputhshëm me referencën. Po qe se hetohet ndonjë mangësi, ndonjë e metë, diçka që nuk shkon, atëherë këtë duhet ta tregojë atë studiuesi.

6. Shqyrtimi kritik ndihmon për ta shquar gjendjen reale

Po e ilustruj qasjen kritike me llupën.

Le të supozohet se një periudhë është e shkruar me shkronja të vogla, dhe mund të duket si krejt në rregull.

Për shkak të shkronjave të vogla, me shikim të rëndomtë periudha në fjalë lexohet me vështirësi. Mund të ketë, por të mos shquhen qartë, presja, pikëpresja apo pika. Për më tepër, mund të mos lexohet ndonjë fjalë, apo ndonjë shifër. E tërë kjo, mund ta krijojë perceptimin se periudha është në rregull gramatikisht. (Aludimi është te sypriniteti i qasjes deskriptive.)

Por perceptimi do të ndryshojë po qe se përdoret llupa. Atëherë, ajo që nuk dukej qartë ose ishte e padukshme për shkak të vogëlsisë, shfaqet e lexueshme dhe ne mund të shquajmë nëse periudha është e thurur mirë, nëse kuptimi është i shprehur qartë, a ka presje, pikëpresje apo shenja të tjera pikësimi dhe a janë të vendosura ku duhet e si duhet etj.

Qasja kritike përmes shqyrtimit kritik duhet të jetë si llupa. Ai duhet t'i shohë si pikëpamjen për ashtu edhe atë kundër, si argumentin ashtu edhe kundër-argumentin, si faktet ashtu edhe kundërfaktet, ashtu sikurse janë, domethënë të shquajë ato që nuk mund të hetohen pa "llupën", pa depërtuar në përmbajtjen e gjithsecilës, dhe pa shquar, nëse ka, defekte ose paqëndrueshmëri. Shqyrtimi kritik, në një diskutim, është një instrument ndihmës përmes të cilit synohet të hetohen dobësitë se cilës apo forcën e secilës, ashtu sikurse është realisht, dhe jo ashtu sikurse pretendon njëra apo tjetra, apo sikurse duket njëra apo tjetra.

(Vijon)

(Autori është prof. ass. dr. dhe ka ligjëruar për shumë vjet lëndët Shkrimi akademik dhe Metodologjia e hulumtimit shkencor)

Trumpi nuk pret shumë nga takimi me Putinin

UASHINGTON, 15 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, thotë se ka pritshmëri të vogla nga takimi me presidentin rus, Vladimir Putin, sot (e hënë) në Helsinki. "Shkoj me pritshmëri të vogla", tha Trumpi në një intervistë për "CBS News".

"Nuk shkoj (në samit) me pritshmëri të mëdha", shtoi presi-

denti amerikan.

Presidenti Trump tha se asgjë e keqe nuk do të ndodhë dhe ndoshta diçka e mirë do të dalë nga ky takim. "Mendoj se është mirë që takohemi. Unë besoj në takime", tha Trumpi.

Presidenti amerikan tha se në takimin me Putinin do ta ngrehë çështjen e padive ndaj 12 spi-

unëve rusë, të cilët autoritetet amerikane i akuzojnë për ndërhyrjen në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016. Trumpi shtoi se ai nuk e ka menduar, që ta pyesë Putinin që t'i ekstradojë këta persona në Shtetet e Bashkuara. Kremlin vazhdimisht ka mohuar se ka ndërhyrë në zgjedhjet presidenciale amerikane.



Nielsen: Rusia dëshiron të krijojë ndarje në mesin e amerikanëve

Sekretarja për Siguri Kombëtare, Kristjen Nielsen, gjatë një tubimi të sekretarëve të Shteteve të Bashkuara në Filadelfia më 14 korrik, tha se rusët po përdorin mediet sociale si zëdhënës simpatikë dhe fronte të tjera për të nxitur mosmarrëveshje dhe përçarje në mes të popullit amerikan.



UASHINGTON, 15 KORRIK - Shefja për Siguri Kombëtare të Shteteve të Bashkuara thotë se zyrtarët e inteligjencës po shohin "përpjekje të vazhdueshme ruse" për t'i përdorur mediet sociale dhe burime të tjera, për të krijuar ndarje në mes të popullit amerikan.

Sekretarja për Siguri Kombëtare, Kristjen Nielsen, gjatë një tubimi të sekretarëve të Shteteve të Bashkuara në Filadelfia më 14 korrik, tha se rusët po përdorin mediet sociale si zëdhënës simpatikë dhe fronte të tjera për të nxitur mosmarrëveshje dhe përçarje në mes të popullit amerikan. Ajo shtoi se, megjithatë, këto përpjekje nuk janë "domosdoshmërisht të përqendruara në politikanët dhe fushatat politike".

Sekretarja Nielsen tha se nuk ka shenja se Rusia po synon të ndërhyjë në zgjedhjet afatmesme të këtij viti, me të njëjtën "shkallë dhe shtrirje", që ndërhyri në zgjedhjet presidenciale më 2016 në ShBA.

Komentet e sekretares Nielsen erdhën vetëm një ditë pasi Juria e Madhe në ShBA akuzoi 12 oficerë të inteligjencës ruse për rolin e tyre në sulmet kibernetike në Partinë Demokrate dhe publikimin e e-maileve të vjedhura dhe informacioneve të tjera gjatë fushatës presidenciale më 2016.

Të 12 të akuzuarit janë identifikuar si oficerë në Drejtorinë Kryesore të Shtabit të Përgjithshëm të Inteligjencës ruse, që njihet si GRU. Kjo drejtori është një nga agjencitë kryesore të inteligjencës në

Rusi, së bashku me Shërbimin Federal të Sigurisë (FSB).

Zyrtarët e GRU-së "në kapacitetet e tyre zyrtare u angazhuan në një përpjekje të vazhdueshme për t'i sulmuar rrjetet kompjuterike të Komitetit të fushatës së Partisë Demokrate dhe fushatës presidenciale të kandidatës Hillary Clinton", është thënë në një deklaratë të Departamentit Amerikan të Drejtësisë.

Paditë, që janë bërë publike nga zëvendësprokurori i

Përgjithshëm, Rod Rosenstein, janë publikuar vetëm disa ditë përpara se presidenti Donald Trump të takohet me homologun e tij rus, Vladimir Putin, sot (e hënë) në Helsinki.

I pyetur nëse do të flasë me Putinin për këto padi, Trumpi, i cili vazhdimisht ka minimizuar akuzat kundër Rusesë, tha: "Gjithçka që mund të bëj është

të them 'A e keni bërë?', 'Mos e bëni përsëri'. Por Putini mund ta mohojë këtë gjë", është shprehur presidenti amerikan. Kremlin vazhdimisht ka hedhur poshtë akuzat për ndërhyrje në zgjedhjet në ShBA. Ministria e Jashtme ruse i ka cilësuar paditë si "një komedi e turpshme", duke shtuar se ato kanë për qëllim ta pengojnë samitin në Helsinki.

Në komentet e saj, sekretarja Nielsen tha se agjencia e saj do t'i ndihmojë zyrtarët në qytetet dhe shtetet e ShBA-së për ta përgatitur sistemin elektoral për t'u mbrojtur nga sulmet kibernetike nga Rusia dhe gjetkë. Edhe pse votat nuk janë ndryshuar gjatë zgjedhjeve presidenciale më 2016, tha ajo, çdo përpjekje për të ndërhyrë në zgjedhjet tona qoftë suksesishme apo jo, është sulm në demokracinë tonë", tha ajo.

Zyrtarët e disa shteteve gjatë tubimit në Filadelfi thanë se është e rëndësishme që presidenti Trump të ketë një qëndrim më të ashpër kundër Rusesë, në mënyrë që të ndihmojë që publiku të ketë besim në zgjedhjet e ardhshme.

Turqia shënon përvjetorin e dytë të puçit të dështuar



ANKARA, 15 KORRIK - Turqia ka shënuar përvjetorin e dytë të puçit të dështuar ushtarak ndaj presidentit dhe Qeverisë, ngjarje në të cilën u vranë 250 persona. Presidenti turk, Rexhep Tajip Erdogan dhe zyrtarët e lartë shtetërorë kanë marrë pjesë në një ngjarje ku u recitua Kur'an në Ankara, duke nisur kështu një sërë ngjarjesh, që përfshinë edhe lutje.

Më 15 korrik 2016 fraksione të ushtrisë përdorën tanke, avionë luftarakë dhe helikopterë, në tentim për të rrëzuar nga pushteti presidentin Erdogan. Në shumë qytete, përfshirë Stambollin dhe Ankarën, pati përleshje. Turqia e fajëson klerikun Fethullah Gulen se qëndron prapa këtij tentim grushtshteti. Gulen, i cili jeton në Shtetet e

Bashkuara, mohon çdo përfshirje në këtë ngjarje.

Që nga 15 korriku i vitit 2016, autoritetet turke kanë arrestuar dhjetë-mijëra persona, përfshirë shërbyes civilë, gazetarë dhe mësues, duke i akuzuar ata se janë mbështetës të Gylenit. Dhjetë-mijëra persona të tjerë janë përjashtuar apo pezulluar nga puna për po të njëjtën akuzë.

Në Haiti jep dorëheqje kryeministri pas protestave të dhunshme

HAITI, 15 KORRIK - Kryeministri i Haitit, Jack Guy Lafontant, dha dorëheqje pas disa ditë protestash kundër planeve të qeverisë për rritjen e çmimit të karburantit. Ai tha se ia kishte paraqitur dorëheqjen presi-

dentit të vendit, i cili e kishte pranuar dorëheqjen e kryeministrit. Në Haiti ka pasur mjaft trazira ditët e fundit për shkak të njoftimit të planeve nga qeveria për rritje të konsiderueshme të çmimit të kar-

buranteve.

Njoftimi u pasua me protesta të dhunshme, që shkaktuan vdekjen e katër personave. Qeveria u detyrua ta anulojë vendimin e saj, por trazirat politike sollën një votë mos-

besimi në Dhomën e Ulët të Parlamentit të Haitit. Departamenti amerikan i Shtetit i ka paralajmëruar shtetasit amerikanë të mos shkojnë në Haiti për shkak të trazirave në ditët e fundit.



Fjalë e mbajtur në konferencën shkencore "40 vjet veprimtari shkencore e krijuese të prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha"

Instituti i Historisë së Kosovës krenohet me veprimtarinë shkencore të prof. dr. Sabile Keçmezi-Bashës



Prof. dr. Sabit SYLA,
drejtor i Institutit të Historisë

*E nderuar, familja Basha - Keçmezi
Të nderuar miq e shokë të koleges,
prof. dr. Sabile Bashes*

Të nderuar të pranishëm,

Sot, jorastësisht, jemi tubuar këtu ne, kolegët, për t'i shprehur mirënjohjen tonë ndaj punës, hulumtimit, kolegialitetit dhe veprës që na dha ndër vite, studiuesja Sabile Basha, në fushën e shkencës së historisë në Kosovë dhe jashtë saj për katër dekada me radhë. Po, të ndalemi për një çast, të llogarisim se, gjatë këtyre viteve, 40 nga to, i kaloi në arkiva e biblioteka të ndryshme duke gjurmuar, hulumtuar e grumbulluar të dhëna historike për origjinën, luftën dhe padrejtësitë e shumta që i përjetoi populli ynë.

Gjatë të gjitha viteve prof. dr. Sabile Keçmezi është dëshmuar me punën e vet këmbëngulëse në fushën e hulumtimeve shkencore, e cila më vonë u kurorëzua me rezultate në fushën e historiografisë, të cilat edhe sot janë evidente. Angazhimi i saj në fushën e shkencës dëshmon se ajo ishte edhe femra më e re shqiptare në Kosovë e cila mori titullin e doktorit të shkencave. Nga viti 1987 (kur botoi edhe veprën e parë shkencore "Zhvillimi historik i PKJ-LKJ në Kosovë 1945-1966", e cila kishte bërë bujë të madhe tek pushtetarët e kohës, (për 6 muaj u ndalua që të shitej, arsyeja ishte se autorja kishte shkruar në bazë të të dhënave për shpërnguljet e shqiptarëve për Turqi). Pas presionit dhe kërcënimeve që iu bënë, që e detyruar që nga libri t'i largoi disa faqe, vetëm e vetëm që të dalë libri në dritë. Pas botimit të librit në fjalë, ajo edhe më me ngulm filloi të hulumtoj dhe studioj për situatën politike dhe lëvizjen ilegale patriotike në Kosovë, si rezultat i tyre ishin edhe veprat e shumta të cilat i botoj më vonë siç ishin: "Lëvizja ilegale patriotike shqiptare në Kosovë 1945-1947" (1998); "Lëvizja ilegale patriotike në Kosovë 1945-1947" e riboton në Shkodër (1999); "Organizata dhe grupet ilegale në Kosovë 1981-1989" (2003); Më 2009, boton librin për shtypin ilegal në Kosovë që e ka titulluar: "Shtypi ilegal shqiptarë në Kosovë 1945-1999", dhe po në këtë vit ka botuar librin mjaft voluminoz (600 f): "Të burgosurit politikë shqiptarë 1945-1990", i cili nga komuniteti shkencor dhe opinioni i gjerë është pritë me vlerësime të larta pozitive shkencore. Pastaj në vitet e mëvonshme botoi Kosova në shtypin e mërgatës shqiptare (1945-1990) II (Lajmëtar i Lirisë; Përpjekja Kosovare), Kosova në shtypin e mërgatës shqiptare (1945-1990), III,

(Qëndresa Shqiptare; Krah i Shqiptonjës; Kosovarja e Re)", Kontributi atdhetar i Hyrije Hanës". Ndërsa për 100-vjetorin e shtetit shqiptar hapi Ekspozitë "Shtypi i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare (1945-1999)", 26 nëntor, 2012 në Gjilan. Më 2012 botoi librin: Sulejman Krasniqi-Veprimtaria atdhetare, për të vazhduar me botimet e librave të rinj si: Vlerësime politiko-historike, 2012; Veprimtaria atdhetare ilegale në Anamoravë 1945-1968; Programet politike të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare 1878-1990; Kosova 1945-1990, (Vështrim historiko-politik, 2016; Procesi gjyqësor i Prizrenit, 1946, 2018; Ngjarjet, dëshmitë dhe identiteti kombëtar, 2018; Ballafaqim me dëshmitë historike, 2018; 40-vjet veprimtari shkencore (Biografia dhe bibliografia), 2018, Mbresa nga Stambolli dhe Bursa dhe me qindra punime të tjera.

Në bazë të të dhënave, prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha, për të arritur te këto rezultate shkencore ka hulumtuar me vite, në shumë arkiva të ish-Jugosllavisë, të Shqipërisë dhe në Kosovë. Ka shfrytëzuar materialet arkivore që veprave të saja iu shtojnë vlerën dhe e bëjnë një hulumtues të denjë të shkencave të historisë. Ajo pa marrë parasysh vështirësitë që i dilnin në rrugën e hulumtimeve me një pasion të paparë ka hulumtuar: në Arkivin Qendror të KQ të LKJ-së në Beograd, në Arkivin Shtetëror të Serbisë, në Bibliotekën Popullore të Beogradit; Ka hulumtuar në Arkivin Shtetëror të Shqipërisë; Në Kosovë, ka hulumtuar në Arkivin Kombëtar të Kosovës, në Arkivin e Komitetit Krahinor të Kosovës; në arkivat e Gjykatave të qarqeve si në Prishtinë, Pejë, Gjilan, Mitrovicë, Prizren. Po ashtu ka hulumtuar në arkivat komunale si në Dardan, Gjilan, Prizren, Gjakovë etj. Për hulumtimet e shumta shkencore dhe të arritura e saja dëshmojnë edhe volumet e shumta të veprave të saja, që i ka në dorëshkrim (mbi 3.000 faqe), por për hir të situatës së rënd materiale që ndodhen institucionet tona, po presin ditën më të mirë të botimit. Veç kësaj ka shfrytëzuar arkivat private te disa personaliteteve të kohës që kanë zhvilluar aktivitete të dendura kombëtar për çështjen e Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi, si në SHBA, në Paris, Stamboll e Itali. Literaturën relevante me një mjeshtri të rrallë e ka shfrytëzua për qëllime të rezultateve shkencore.

Veç botimeve (monografive) të veçanta që i ka botuar, ajo një numër të madh të shkrimeve shkencore ka arritur ta botoj në bashkautorësi me shkencëtarë të tjerë dhe gjithashtu i ka botuar në revista shkencore e gazeta të ndryshme si në Kosovë po ashtu edhe jashtë. Duhet përmendur revistat: "Studime historike" (IHT), Tiranë; "Studime albanologjike", - seria e shkencave historike (IA), Prishtinë; "Kosova" (IHP), Prishtinë; në revistën "Vjetari" të Arkivit të Kosovës. Gazeta "Dielli"

SHBA; gazeta "Albanezule", Rumani, revista shkencore "La Radici", Itali etj. Duhet përmendur se punimi "Karakter kombëtar i Lëvizjes ilegale shqiptare në Kosovë 1945-1990" i është botuar edhe në librin përmbledhje punimesh "1 Uslulararasi Balkanlarda Tarih ve Kultur Kongresi", 2009. Universiteti i Sakarias, Turqi.

Shkrime të caktuara shkencore i janë botuar edhe në Mal të Zi e Maqedoni në organet e atjeshme si dhe Kroaci, Bosnjë e Slloveni. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka marrë pjesë edhe në aktivitete të rëndësishme shkencore, si në kongrese, simpoziume, konferenca shkencore, tryeza të rrumbullakëta, debate, etj. Ndër të cilat do të veçonim: Uslulararasi 1. Balkanlarda Tarih ve Kultur Kongresi - Kongresi I Ndërkombëtar Ballkanik "Historia dhe Kultura e Ballkanit, 11-12. 05. 2009. Prishtinë.

Tema: Karakteri kombëtar i Lëvizjes Ilegale Shqiptare në Kosovë 1945-1990, Seminari XXIX



Drejtori i Institutit të Historisë, prof. dr. Sabit Syla, duke i dorëzuar "Mirënjohjen për kontributin e jashtëzakonshëm në shkencat e historisë" prof. dr. Sabile Keçmezi-Bashës

Ndërkombëtar për Gjuhë, Letërsi dhe Kulturë Shqiptare, 16-27 korrik, 2010, "Lëvizja ilegale patriotike shqiptare në Kosovë 1945-1990"; "75-vjetori i hapjes së shkollave shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore", Shkup, 20 nëntor 2016. Fakulteti i Studimeve Islame, konferencë shkencore për 30-vjetorin e daljes së revistës "Dituria islame", Konferencë shkencore, "Veprimtaria Atdhetare dhe Intelktuale e Adem Demaçit", organizuar nga Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë dhe Shoqata e të burgosurve politikë të Kosovës, 29 shkurt 2016; Ambasada hungareze në Kosovë, Konferencë për "60-vjetorin e Revolucionit Antikomunist në Hungari", 21 tetor 2016, Conference on inclusion in Higher Education, organizuar nga Canadian International Development Agency, 9-10 shkurt 2006, Konferencë shkencore ndërkombëtare "The Role of Diplomacy in the History of the Balkans", 9-10 nëntor, 2017; Konferenca shkencore "Lëvizja studentore në Kosovë dhe protesta e 1 Tetorit 1997", Universiteti i Kosovës, 2 tetor 2017; Konferencë shkencore, Jashar ët në luftën çlirimtare, 6 mars 2018; Simpoziumi Shkencor

"Deklarata kushtetuese dhe Kushtetuta e Kaçanikut", 2 korrik 2010, Prishtinë, Tema: "Suspendimi i autonomisë së Kosovës"; Simpoziumi shkencor "Mitrovica... Tema: Lëvizja ilegale atdhetare në Rajonin e Mitrovicës 1945-1990"; Promovimi i librit Prof. Shani Hoxha, Qamil F. Hoxha "Drini", Skenderaj, 2 tetor 2009. (fjalë rasti); "E djathta shqiptare", 26 korrik, 2009. Shkup, "Hasan Bilalli dhe ndikimi i tij në NDSH"; Pavarësia e Kosovës, simpozium shkencor, IHK. 12 qershor 2009, tema "Pavarësia e Kosovës dhe veprimtaret ilegal të Lëvizjes Kombëtare"; "Demonstratat e gjashtëdhjetetës", 40-vjetori i tyre, (Konferencë shkencore), 24-25 nëntor 2008. Tema: Karakteri kombëtar i Programit të Demonstratave 1968"; "Lidhja Shqiptare e Prizrenit", 130-vjetori i saj, (Konferencë shkencore), 10-11 qershor 2008, Prishtinë. Tema: "LSHP në Programet e organizatave ilegale në Kosovë 1945-1990"; "Jeta dhe vepra e Akademik Ali Hadrit",

muar katërçipërisht se monografitë dhe punimet e saja kanë vlerë të lartë shkencore dhe ka kontribuar dukshëm si për nga cilësia po ashtu edhe për nga sasia në shkencën e historisë më të re të Kosovës. Ajo është një studiuese e palodhshme e cila edhe në të ardhmen premton shumë në të mirën e shkencës dhe të vet shtetit të ri të Kosovës në veçanti dhe të arriturave shkencore universale në përgjithësi.

Duke shfletuar biografinë dhe bibliografinë shkencore të zonjës Basha, e sidomos monografinë kërkuese hulumtuese e studimore "Të burgosurit politikë shqiptarë 1945-1990" vijmë deri te të dhënat rrëqethëse për rezistencën dhe sakrificat që bëri populli shqiptar nëpër vite, vetëm e vetëm për të realizuar qëllimin suprem të shumë brezave që u viktimizuan në altarin e lirisë për një shtet sovran dhe të pavarur - Republikën e Kosovës, dhe në këtë monografi siç e quajti dikush "monument" për popullin shqiptar, vijmë të të dhënat shokuese ku shqiptarët nga gjykatat ish-Jugosllave u ndëshkuan me, hiq më pak se 666 shekuj, 72 vjet e 7 muaj burgim.

Në fushën e shkencës, krahas projekteve të ndryshme të Institutit të Historisë në Prishtinë, dhe më gjerë, prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha ishte recensente e shumë veprave publicistike-shkencore, anëtare e revistës shkencore historike "Kosova", te Institutit të Historisë - Prishtinë, revistës "Studime Historike", në Tiranë, redaktore profesionale e veprave të ndryshme shkencore" dhe botimeve të veçanta shkencore, në revista e gazeta të ndryshme, dhe ka dhënë shumë kontribute në trajtesa tjera, kryesisht për shekullin XX. Mbi këtë bazë të përgjithshme, sot, Sabile Basha zë një vend të veçantë si një historiane e spikatur, e ngritur në historiografinë shqiptare në një kolose të veçantë, për çka flasin veprat dhe puna e saj voluminoze si dëshmia më e besueshme, më e fortë që na lë testament për gjeneratat e ardhshme. Të nderuar të pranishëm,

Ne i urojmë prof. dr. Sabile Bashës edhe shumë vite të tjera, të shëndetshme në dobi të shkencës, atdheut e kombit; dhe në këtë përvjetor të 65 të jetës së saj më lejoni t'i drejtohem me këto fjalë: E nderuara profesorësh: "Kurrë mos e përfill peshën e viteve, se ke edhe shumë vite të tjera jetë e punë për të kaluar, se mendja e kthjellët e njerëzve në moshën tuaj premton punë të madhe e të frytshme". Ne, kolegët tu me dashamirësi kërkojmë që punën shkencore edhe më tej ta lëvrosh dhe të na ofrosh vepra edhe më të mira shkencore. Dhe krejt në fund, me këtë rast të shënuar, nga zemra të uroj 65-vjetorin e lindjes dhe 40-vjetorin e veprimtarisë shkencore duke të dëshiruar edhe shume vite të tjera sa të mbara aq edhe të rehatshme. Me shumë respekt e mirënjohje për gjithçka, e nderuar prof. Basha! Ju faleminderit!


E rrallë

U përpoq t'i kapte çelësat, e kaloi natën me dorën e ngecur në tualet

Një burrë, i cili jeton i vetëm në një banesë në Jingzhou të Kinës, e kaloi natën me dorën e ngecur në tualet, pasi u përpoq t'i merrte çelësat që i kishin rënë. Teksa ka bërë titur duke kërkuar ndihmë, atë e ka dëgjuar një fqinjë gjatë orëve të mëngjesit dhe ka kërkuar ndihmën e zjarrfikësve.



FOTO E DITES



Një performancë e ansamblit të ri para hapjes së natës "The Joyce Theatre" në Nju Jork. /AFP/

E jashtëzakonshme

Akullorja që nuk shkrihet

Le t'i themi lamtumirë akullore tradicionale. Moda e re, e nisur në Nju Jork, quhet "Booza". Akullorja këputet si mozzarella dhe mund të shijohet duke e rrotulluar rreth lugës. Ajo sfidon temperaturat më të ngrohta dhe nuk shkrihet, duke u kthyer në "domosdoshmërinë" e kësaj vere.




DASHI
Ngrohtësia dhe harmonia që do të

gjeni pranë miqve tuaj sot do t'ju bëjnë edhe juve një person më të mirë dhe me solar.



DEMI
Keni filluar të mendoni për disa dhurata që

do të bëni dhe doni të gjeni ide origjinale për të kënaqur personat që keni pranë vetes.



BINJAKËT
Sot jeni shumë të hapur dhe të sinqertë.

Zonat gri dhe çështjet e pazgjidhura ua u keni lënë të tjerëve për t'u marrë. Ju doni të jeni i vërtetë.



GAFORRJA
Sot ju sugjerohet të kurseni që

në të ardhmen të investoni në projekte fitimprurëse dhe afatgjata. Do të merrni frytë shumë shpejt.



LUANI
Ironia e të tjerëve karshi jush po ju

argëton pamasë. Do të bëheni pjese e lojës duke treguar se dini të menaxhoni situata delikate më mirë nga sa mendoni.



VIRGJERESHA
Jeni shumë të ngarkuar dhe do të

filloni të ndani përgjegjësitë dhe tek kolegët tuaj. Jo çdo gjë mund ta zgjidhni vetë.



PESHORJA
Do të keni disa luhatje humori sot

gjatë pasdites por nuk keni mundësi t'i shmangni. Ka gjëra që duhet të përballeni dhe mënyra më e mirë është duke folur.



AKREPI
Edhe pse ka persona me të cilët nuk shkoni

shumë mirë për gjëra të caktuara, sot do të mund të bashkëpunoni për një kauzë të madhe.



SHIGJETARI
Sot do të keni emocione dhe ndjenja

të veçanta. Jeni shumë të ndjeshëm kohët e fundit.



BRICJAPI
Jeni në një komunikim me vetveten

sot sepse doni të evidentoni ato defekte që shpesh herë ju bëjnë të humbni vëmendjen.



UJORI
Ditë e shkëlqyer sot për ju që jeni

gjithë kohën të zënë me gjëra të reja dhe kreative. Keni formuar një ambient mjaft të këndshëm rreth vetes.



PESHQIT
Ditë jo shumë e mirë për ata nga ju që kanë

pasur probleme financiare. Sot financat tuaja do të thellohen edhe më shumë dhe nuk do të keni mundësi të reagoni.

BARSOLETA E DITËS



Babai, djalit:

- Si po ecin mësimet?
- Po mësoj aq sa di.
- Mos i mëso ato që i di, por ato që s'i di.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

“INCREDIBLES 2” 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



Në ora 18:20

“FUTURE WORLD”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

“ANT-MAN AND THE WASP” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

“LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

Rita Ora do ta realizojë një film horror?



Rita Ora dëshiron që të bëhet ylli i një filmi horror. Këngëtarja e famshme, e cila së fundmi u shfaq në '50 Shades of Grey', ka zbuluar se nuk do t'i shpëtonte asnjë shans për të realizuar më shumë filma, edhe pse për të muzika mbetet prioritet.

"Unë kam aktruar për herë të parë në moshën 11-vjeçare në filmin 'Spivs'. Më pëlqen të aktroj. Aktrimi është si një performancë", ka thënë bukuroshja 27-vjeçare. E pyetur për rolin që po kërkon, Rita tha: "Do më pëlqente një film horror".

Kourtney Kardashian shëtit me fëmijët



Kourtney Kardashian është fotografuar në Los Angeles me fëmijët e saj, djalin Mason, 8 vjeç dhe vajzën Penelopë, 6-vjeçare. 39-vjeçarja dukej mjaft tërheqëse,

veshur me një palë pantallona të gjera, bluzë të shkurtër dhe këpucë të zeza. Ndërsa e bija ishte veshur me një fustan të gjatë si një princeshë e vërtetë.



Meghan Markle shpenzon 155 mijë paund për 15 veshje

Nuk janë bërë ende dy muaj kur Prince Harry dhe Meghan Markle kurorëzuan dashurinë e tyre, mirëpo mediet britanike janë revoltuar nga shpenzimet për veshje të dukeshës së re. Që pas martesës me princin, ajo ka pasur një agjendë të ngjeshur me aktivitete

dhe për këtë arsye i është dashur të shpenzojë edhe për veshje luksoze. Sipas "Daily Mail", në 15 daljet e saj publike Meghan ka veshur 15 firma të ndryshme, secila prej tyre më e shtrenjtë se tjetra. Media britanike thekson se këto veshje të dukeshës kanë kushtuar 155 mijë paund.

Cheryl, këngë të re për ndarjen e dhimbshme nga Liam Payne

Cheryl është ndarë kohët e fundit nga bashkëshorti Liam Payne. Dhe tani është zbuluar se këngëtarja do të flasë për dhimbjen që përjetoi nga ndarja në këngën e saj të fundit që do të publikohet së shpejti. 35-vjeçarja ka shkruar një seri melodish personale. Muzika është prodhuar nga "The Invisible Men", me të cilin Cheryl ka punuar me albumin e saj të fundit Only Human.



Kujdes! Ja pse mbipesha rrezikon të shkaktojë kancer!

Një epidemi që nuk tregon asnjë shenjë të ngadalësimit, por përkundrazi rritet pa u ndalur. Ashtu si beli i prej më shumë se dy miliardë individësh në botë që janë mbipeshë ose obezë. Kilet e tepërta janë një problem që prek 30% të popullsisë dhe shkaktojnë deri në 4 milionë vdekje çdo vit, 40 për qind e tyre në njerëz që ishin “vetëm” mbipeshë dhe jo obezë. Vdekjet kryesisht për shkak të sëmundjeve kardio-vaskulare, por edhe tumoreve. Në këto 8 pika janë gjithçka që duhet të dini.

Ata që janë mbipeshë, rrezikohen nga tumoret më agresivë

“Disa studime kanë treguar qartë se pesha e tepërt jo vetëm që rrit shanset për t’u sëmurë, por edhe për të vdekur nga kanceri, – thotë Giordano Beretta, presidenti i zgjedhur i Shoqatës Italiane të Onkologjisë Mjekësore (Aiom). Njerëzit që janë obezë ka gjasa të zhvillojnë forma më agresive dhe të vështira për t’u trajtuar, si dhe ka më shumë gjasa që të ketë një përsëritje të tumorit të mëparshëm ose të përballat me komplikime gjatë trajtimit. Në pacientin obezë, trajtimi ka të ngjarë të reduktohet ose të jetë e tepruar për shkak të shpërndarjes së ndryshme të ilaçit që ndodh në yndyrën e trupit. Për fat të mirë ne gjithashtu e dimë se humbja e peshës kontribuon, konkretisht, në përmirësimin e situatës”.

30% e popullsisë së botës peshon shumë

Për të dhënë vlerësimet më të fundit të epidemisë është një studim i botuar në revistën shkencore New England Journal of Medicine, e cila analizoi të dhënat e pothuajse 70 milionë të rriturve dhe fëmijëve në 195 vende midis 1980 dhe 2015. Nga shtatë miliardë e banorët e planetit, më shumë se dy kalojnë peshën e rekomanduar: ata kanë një indeks masiv të trupit prej më shumë se 25 (obeziteti fillon mbi 30). Në vitin 2015, pothuajse 108 milionë fëmijë dhe mbi 600 milionë të rritur ishin obezë. Dhe që nga viti 1980 shkalla e obezitetit është dyfishuar në 70 vende, ndërsa në të tjerat vetëm është rritur. Në shumë vende, fëmijët janë më së shumti obezë sesa të rriturit.

Në 2022, më shumë fëmijë të shëndoshë

Një studim në tetor 2017 mbi Lancet, i kryer nga Kolegji Imperial i Londrës dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë, tregon se numri i



fëmijëve dhe adoleshentëve obezë të moshës 5-19 vjeç në botë është rritur 10 herë në 40 vitet e fundit. Nëse trendi i vëzhguar do të vazhdojë në vitin 2022, në vendet perëndimore, do të ketë më shumë fëmijë dhe adoleshentë obezë sesa mesatar ose nën peshë.

Gjashtë lloje të tumoreve që lidhen me kilet e tepërta

Sipas vlerësimeve më të fundit, mbipesha është përgjegjëse në Itali për rreth tre për qind të të gjitha kancereve në meshkuj dhe shtatë për qind të atyre në femra. Ka shumë hulumtime ende të hapura, por informacioni i disponueshëm deri më tani nuk lë hapësirë për dyshim: obeziteti dhe mbipesha janë ndër faktorët e njohur të rrezikut për endometrial, kolorektal, ezofag, veshkë, pankreas dhe kancer të gjirit, veçanërisht në mesin e grave post menopauzë. Shkencëtarët, në vitet e fundit, kanë bërë shumë përparim në shpjegimet e mundshme të mekanizmave të ndryshëm që bazojnë lidhjen mes peshës së tepërt dhe kancerit. Për momentin ekzistojnë pesë fusha, në të cilat po hetojnë për të kuptuar marrëdhëniet shkak-pasojë midis obezitetit dhe tumoreve: insulinë, inflamacion kronik, estrogen, faktorë rritës të tumoreve dhe adipokineve (substancë të prodhuara nga indet dhjamore që kanë një inflamator).

Pse mbipesha shkakton kancer: insulina

“Njerëzit obezë shpesh kanë në gjak nivele të larta të insulinës dhe faktorët e rritjes së insulinës më të larta se normale, – thotë Giordano Beretta, kreu i Njësisë Operative Humanitas Gavazzeni Medical Onkologjisë. – Kjo gjendje, e njohur si hyperinsulinemia ose rezistenca e insulinës, rrit rrezikun e diabetit dhe mund të nxisë fillimin e llojeve të caktuara të kancerit, të tilla si zorrës së trashë dhe veshkës”. Insulina është hormoni i prodhuar nga trupi ynë në përgjigje të rritjes së sasisë së sheqerit në gjak (glycemia), por gjithashtu rregullon aspekte të tjera të funksionimit të trupit tonë dhe prandaj konsiderohet si një hormon kyç në marrëdhëniet midis ushqimit dhe kancerit. Shumë insulinë në qarkullim, për shembull, shkakton prodhimin e tepruar të testosteronit, hormonit seksual mashkullor, te gratë. Përveç kësaj, insulina nxit prodhimin e një faktori rritjeje të quajtur IGF-I, i cili është një pleh i vërtetë për qelizat në përgjithësi dhe në veçanti për ato kancerogjene.

Për mbipesha shkakton kancer: inflamacioni kronik

“Në ato që janë shumë mbipeshë – vazhdon Beretta – është mjaft e zakonshme edhe një inflamacion

kronik i disa indeve (të lehtësuar nga yndyra e grumbulluar në pjesë të caktuara të trupit), i cili njihet si një nga faktorët që në afat të gjatë predispozitojnë transformimin kancerogjen të qelizave. Në fakt, yndyra është një depozitë e natyrshme e substancave që nxisin inflamacionin dhe gjithashtu prodhon hormone, si estrogene, që janë të përfshira në lloje të ndryshme të tumoreve”. Një shembull i të gjitha është ai i inflamacionit kronik në ezofag, me pasojë zbatice gastroesophageal dhe një patologji të njohur si Ezofag i Barret, të dy më të shpeshtë në mesin e obezëve sesa të ato me peshë normale, të dy të njohur si kushte që lehtësojnë zhvillimin e kancerit ezofag.

Pse mbipesha shkakton kancer: estrogeni

Organizata Botërore e Shëndetësisë ka dhënë alarmin prej disa vitesh. Gjithashtu estrogene, të cilat prodhohen në sasi të mëdha nga indet e dhjamit (si dhe në vezore gjatë viteve të fertilitetit në femra), janë ndër përgjegjësit e njohur për disa forma të kancerit të gjirit, endometrit dhe vezoreve. “Estrogeni i prodhuar nga indet dhjamor punon në të njëjtën mënyrë si ajo e prodhuar nga vezoret gjatë jetës pjellore duke stimuluar rritjen e qelizave që zakonisht i nënshtrohen një aktiviteti të estrogeneve, si qelizat e gjëndrave të qafës së mitrës dhe endometriumit, – shpjegon

Beretta. – Në pacientët të cilët më parë kanë pasur tumore të gjirit ose të mitrës, estrogeni i tepërt i lidhur me indet e tepërta të yndyrës mund të lehtësojë shfaqjen e recidivave”.

Kujdes ndaj këtyre 5 vlerave: sindromi metabolik

Në përgjithësi, për të thjeshtuar, ne flasim për një “marrëdhënie të rrezikshme” midis kancerit dhe obezitetit, por përgjegjësia reale është sindromi metabolik, i cili ndërhyr në të gjitha fazat e tumorit, nga trajnimi deri në progresion, nga rezistenca ndaj trajtimit deri në fillimin e recidivave. Një patologji – sqaron onkologun – karakterizohet nga një rritje në perimetrin e barkut (më shumë se 88 cm në femra dhe 96 në meshkuj), hipertension arterial, hypertriglyceridemia (mbi 150 trigliceride trigliceride për decilitër të gjakut), nivele të reduktuara të kolesterolit të “mirë” (më pak se 50 në femra dhe 45 në meshkuj) dhe rritja e glukozës së plazmës së agjërimit (më e madhe se 100). Nëse keni vetëm tre nga pesë prej këtyre karakteristikave ju vuani nga sindromi metabolik dhe rreziku i ngritjes së kancerit (përveç diabetit dhe sëmundjeve kardiovaskulare), sepse krijon një mikro-mjedis të favorshëm për qelizat e kancerit për t’u zhvilluar dhe përhapur”.

(gazeta-Shqip.com)

Pushime me vjehrrën: Gjithçka që duhet të dini...

Nëse mendoni ta bëni vjehrrën një aleate dhe t'i fitoni zemrën bashkëshortit apo të dashurit merreni vjehrrën me vete me pushime. Sado e vështirë t'ju duket ditët nuk do jenë aq të këqija me të. Duke i bërë një ftesë të tillë ju do të fitoni zemrën e burrit tuaj gjithmonë, dhe pas kësaj mund ti kërkonit çdo gjë.

Por përpara se të bëni një ftesë të tillë që sigurisht nuk do t'ju refuzohet, duhet të punoni pak me veten. Ju duhet të jeni e buzëqeshur gjithë kohës dhe duhet ti fshihni të gjitha pakënaqësitë që do të lindin nga "pushime të tilla".

Do përpiqeni të kaloni gjithçka dhe të tregonin përkushtimin ndaj familjes suaj. Nëse me familje tuaj do të bashkohet dhe vjehrra harroni se këto do të jenë pushime për ju. Ajo duhet të jetë qendra e vëmendjes dhe ju duhet të punoni



që ta bëni që ajo ta ndjejë këtë gjë. Ta ftoni të hani bashkë mëngjesin dhe t'ia lini asaj ta zgjedhë restorantin apo menynë ku do të

hani drekën. Të njëjtën gjë duhet të bëni dhe në mbrëmje. Ju nuk mund të dilni shëtitje buzë detit me bashkëshortin. Lëreni të shijojë

i vetëm kafën në hotel. Merrni vjehrrën tuaj për shëtitje ose mund ta bëni shëtitjen të gjithë bashkë. Bisedat janë shumë të

rëndësishme në kohë të tilla. Ju duhet të flisni shumë pak ndërsa atë lëreni t'u tregojë histori të familjes apo kohës kur ishte e re. Me bashkëshortin nuk duhet të bëni biseda mbi planet tuaja në tryezë pasi kjo do të zgjojë vëmendjen e saj për t'ju orientuar. Më pas gjithçka që do keni përgatitur nuk do të shkojë ashtu siç e kishit parashikuar. Por ju mund të bëni biseda të tjera ku këshillat e saj mund ti vini në jetë. Nuk duhet të shkoni asnjëherë të flini para saj aq më tepër pa e pyetur në i duhet diçka për mbrëmjen. E nëse doni që pushimet për të, të jenë të paharuar blini një tufë lule dhe lërxani mbi tryezë, por jo me emrin tuaj por të bashkëshortit tuaj. Ajo duhet të dijë se do jetë gjithmonë mbretëresha e tij.

(gazeta-Shqip.com)

Pushimet, disa këshilla për ata që duan të udhëtojnë vetëm!

Për domosdoshmëri, për zgjedhje të vetëdijshme, për të qenë vetëm dhe për të shijuar pavarësinë tuaj: ja gjërat që duhet të dini

Këtë vit doni t'i bëni pushimet për llogari tuajën. Arsyet mund të jenë nga më të ndryshmet: ndoshta për shkak se nuk keni gjetur shoqëri, ose është zgjedhje e lirë, për shembull, për të rizbuluar veten ose për të rifituar kohën tuaj. Sidoqoftë, pushimi është një horizont i lirë që hapet para jush dhe hap mundësi të pafundme, të gjitha për t'u shijuar në maksimum. Nëse jeni në përvojat tuaja të para të këtij lloji, këtu janë disa këshilla për t'u organizuar në mënyrën më të mirë dhe për të parandaluar ndonjë shqetësim të pashmangshëm.

Ankthet më të zakonshme – Një studim i kohëve të fundit ka treguar se gratë që udhëtojnë pa shoqëri kanë disa shqetësime të përbashkëta. Më e përhapura është të bësh disa takime të pakëndshme, të cilat mund të kthehen në diçka më serioze. Ndër masat që mund të merrni janë rregullat e zakonshme të sensit të mirë: i kushtoni vëmendje para se të jepni besimin, duke ruajtur sjelljen konfidenciale, duke u besuar instinkteve tuaja dhe duke mbajtur sytë hapur. Një tjetër arsye shqetësuese është të mos arrish të përshtatesh me kushtet lokale ose vështirësitë e hasura gjatë udhëtimit. Zgjidhja e vetme është mbledhja e sa më shumë informacioneve të mundshme përpara nisjes dhe përdorimi i transportuesve seriozë dhe të provuar. Një sigurim ad hoc gjithashtu mund të përcaktohet për ndihmë në rast nevojë.

Udhëtoni lehtë – Më mirë të mos ngarkoheni me shumë bagazhe: me një valixhe të vogël ju lëvizni më lirshëm dhe bini më pak në sy. Idealja është ta menaxhoni bagazhin me një dorë, për ta pasur tjetrën të lirë. Kujdes edhe me çantën: duhet të ketë një mbyllje të sigurt të një rrip të rehatshëm dhe shumë xhepa të brendshëm me zip që t'ju lejojnë të gjeni çfarë keni nevojë pa dështuar, pa pasur nevojë të kërkonit. Nuk duhet të mungojë një ndarje shumë e sigurt, ku mund të ruani dokumentet, kartën e kreditit dhe paratë.

Zakonet lokale – Të jeni të informuar mirë për përdorimin dhe zakonet e destinacionit tuaj, veçanërisht nëse është vend ekzotik dhe i përshtatshëm për ta. Për shembull, nëse vizitoni një vend shumë tradicional, shmangni veshjet shumë të ngjeshura, edhe nëse është nxehtë: zgjidhni pantallona të lirshme, këmisha me mëngë të gjata. Nëse vizitoni një vend musliman është më mirë të grumbulloni flokët dhe të mbuloheni. Është praktikë e mirë të mësoni disa fjalë në gjuhën lokale, në mënyrë që të keni një formë shumë themelore të komunikimit.

Jini të rezervuar – Mos i ndani planet tuaja të udhëtimit me njerëz të sapo-njohur, mos e zbuloni emrin e hotelit tuaj dhe kohën kur planifikoni të largoheni mëngjesin e ardhshëm. Në vend të kësaj, mbani kontakt me të dashurit tuaj



(prindërit, një të afërm ose një mik): krijoni me vete një seri takimesh telefonike dhe gradualisht largoheni nga adresa e hotelit ku keni ndërmend të qëndroni brenda natës. Shmangni vendet që janë shumë të vetmuara dhe rrugët që duken të pasigurta, sidomos gjatë natës. Një masë tjetër paraprake, e sugjeruar nga ekspertët e udhëtarëve, është që të vendosni një unazë në të majtën, duke simuluar një lidhje bashkëshortore, me qëllim që të mbani larg adhuruesit.

Për sigurinë tuaj – Mos vishni gjëra me vlerë ose tepër të mëdha, mos përdorni valixhe apo çanta për projektim, mos i merrni veshjet tepër extravagante. Nëse destinacioni juaj është jashtë vendit, veçanërisht

nëse destinacioni juaj është jo-europian, mund të jetë e dobishme të regjistrohemi në portalin e udhëtimit të sigurt të Ministrisë së Punëve të Jashtme, në të cilën mund të gjeni informacione të dobishme për vendin ku do të vizitoni dhe rreth masave që mund të jenë të dobishme për t'u vënë në zbatim në atë vend. Mbani numrin tuaj të telefonit të gatshëm për të bllokuar kartën tuaj të kreditit dhe kartën e debitit në rast të vjedhjes ose humbjes.

Dolli – Mos e tejkaloni me pije alkoolike dhe substanca që mund t'ju bëjnë të humbni kontrollin e situatës. Nëse kaloni një mbrëmje në një klub, mos e lini pijen tuaj pa mbikëqyrje: ka gjithnjë e më shumë

raste të grave të drogjuara pa dijeninë e tyre.

Fjala e duhur: fleksibilitet – Bukuria e udhëtimit vetëm qëndron në nevojën për të rishikuar dhe vënë në lojë shumë zakone, paragjykime dhe stereotipa që ne tentojmë të përsërisim në përvojën tonë të përditshme. Në një udhëtim "pa rrjet" duhet të jemi krejtësisht dhe pa rezerva. Ana tjetër e monedhës është liria e plotë që mund të përjetohet, duke përfshirë ndryshimin e itinerarit dhe kohën kur mundësia paraqitet. Pra, jini të kujdesshëm, por në të njëjtën kohë shijojeni udhëtimin tuaj. Në fund të fundit, nuk duhet t'i jepni llogari askujt. Kur ishte hera e fundit që ne mund të shijonim këtë luks?

(gazeta-Shqip.com)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

DINAMO BREST - SHAKHTYOR SOL.

1

COPENHAGEN - AC HORSSENS

1

ELFSBORG - HAMMARBY

2

Franca, kampione e Botës

Franca është kampione e botës për herë të dytë në historinë e saj, kurse Kroacia e përfundon e dyta Botërorin "Rusi 2018", që është një sukses historik për këtë reprezentacion. Në vendin e tretë ka përfunduar Belgjika, e katërta Anglia

EPOKA E RE**Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 15 KORRIK - Franca e ka fituar titullin e botës në "Rusi 2018", pasi në finale e ka mposhtur Kroacinë me rezultat 4-2. Loja e zhvilluar në Moskë ka qenë emocionuese dhe ndër më interesantet në histori të ndonjë Botërori. Para nisjes së ndeshjes, në ceremoninë hapëse, ishte këngëtarja nga Kosova, Era Istrefi, e cila interpretoi së bashku me Will Smith dhe Nicky Këngën zyrtare të Botërorit "Live It Up".

Pas fillimit të ndeshjes, kroatët e nisën më mirë lojën, duke dominuar në minutat e parë, por në minutën e 18, pas një ndërprerje, Griezmanni harkon në zonën e rreptësisë dhe Mario Mandzukiqi, në tentim të largimit të topit, shënon autogol. Kjo nuk i dekurajoi kroatët të cilët u rikthyen në lojë vetëm pas nëntë minutave kur realizoi Ivan Perisic. Në minutën e 38 Franca e riktheu epërsinë në 2-1 me golin e Griezmannit nga penalltia. Edhe në fillim të pjesës së dytë

Kroacia ishte dominuese dhe kërkonte golin e barazimit, por Paul Pogba (59) shënoi për 3-1. Gjashtë minuta pas këtij goli realizoi edhe talenti Kylian Mbappe, i cili shënoi gol të bukur për rezultatin 4-1 dhe Franca e siguroi fitoren që më pas e hodhi në diskutim portieri Hugo Lloris, i cili gaboi duke i dhuruar topin Mario Mandzukiqit që realizoi për rezultatin 4-2.

Kroatët e kërkuar golin e tretë, por rezultati mbeti i pandryshuar dhe Franca u shpall kampione e botës. "Është një ndjesi e bukur. Ia kemi dalë mbanë. Skuadra ka kualitet të madh, si mendërisht ashtu edhe teknikisht. Jemi rritur shumë, por nuk ka qenë aspak e lehtë. Kemi punuar shumë, kemi kaluar vështirësitë e shumta dhe jemi shpërblyer. Para dy vjetëve na ka lënduar shumë ajo humbje në finale, por edhe na ka ndihmuar. Tani jemi në majën e botës për katër vjetët e ardhshëm", ka thënë Didier Deschamps, trajner i Francës.

Në vendin e tretë ka përfunduar Belgjika, e cila e ka mposhtur të shtunën Anglinë me rezultat 2-0.



FRANCË-KROACI, 4-2

Stadiumi: "Luzhniki"

Shikues: 78 011

Gjyqtarë: Nestor Pitana (Argjentina)

Karton të verdhë: Kante, Hernandez (Franca), Vrsaljko (Kroacia)

Francë: Lloris, Pavard, Varane, Umtiti, Hernandez, Pogba, Kante (Nzonzi), Matuidi (Tolisso), Griezmann, Mbappe, Giroud (Fekir).

Kroacia: Subasic, Vrsaljko, Striniq (Pjaca), Lovren, Vida, Rakitiq, Modriq, Brozovic, Perisic, Mandzukic, Rebiq (Kramaric).

Ky botëror ka qenë mjaft interesant edhe për shqiptarët, ani pse Shqipëria dhe Kosova nuk ishin pjesëmarrëse. Katër futbollistë shqiptarë u paraqiten për Zvicrën dhe një për Belgjikën dhe katër prej tyre shënuan gola. Dy

golat kryesorë ishin në ndeshjen Zvicër - Serbi: të realizuar nga Granit Xhaka dhe Xherdan Shaqiri. Këta futbollistë festuan golat e fitores ndaj Serbisë me simbolin e shqiponjës dhe ky veprim bëri jehonë në të gjithë botën, por Xhaka dhe Shaqiri u dënuan nga FIFA me nga 10 mijë franga.

Griezmanni, lojtar i finales; Modriqi, i Botërorit

Antoine Griezmann është zgjedhur lojtar më i mirë i finales së "Luzhnikit", ku Franca triumfoi me rezultatin 4-2 ndaj Kroacisë. Sulmuesi dha gjithçka në këtë takim, duke bërë liderin te skuadra franceze, asistoi në autogolin e shënuar nga Mandzukiqi, ndërsa shënoi edhe golin e dytë nga 11 metra. Kapiteni i Kroacisë, Luka Modriq, është zgjedhur nga FIFA si futbollisti më i mirë i

Botërorit "Rusi 2018". Ylli kroat ka qenë në nivel të lartë që nga ndeshja e parë e deri sonte, por nuk ka arritur që trofeun e më të mirit ta sjellë në Kroaci. Ndërsa lojtari më i mirë i ri në këtë Botëror është shpallur Kylian Mbappe.

Kampionët e Francës shpërblehen me 38 milionë euro

FIFA për këtë Botëror ka shpërndarë miliona euro. Këtë herë u shpërndanë 670 milionë euro për të gjitha skuadrat, një shifër shumë më e lartë nga ajo e katër vjetëve më parë, kur kampione ishte shpallur Gjermania. Diferenca mes kampiones, Francës dhe vendit, Kroacisë, është 10 milionë euro. Një buxhet që mund të ndihmojë shumë dy federatat për projektet e tyre (sidomos atë kroate). Franca do të rikthehet në shtëpi me 32.3 milionë euro (38 milionë dollarë), ndërsa skuadra nënkampione e Kroacisë do të përfitojë 10 milionë euro më pak. Kroatët do të përfitojnë 28 milionë euro, ose 23.8 milionë dollarë. Ndërkohë, Belgjika përfitoi 20 milionë euro nga triumfi kundër Anglisë. Ekipet që janë eliminuar në fazën e parë u rikthyen në shtëpi me 7 milionë euro.



Haradinaj mbështet Agushin drejt rekordit të ri në Dubai

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, nëpërmjet një postimi në "Facebook" ka treguar se është takuar me Agim Agushin, rekordmenin botëror dhe të Guinnessit për

goditjen e topit me kokë. Haradinaj, po ashtu, ka treguar se caku i radhës së Agushit është "Burj Khalifa", ndërtesa më e lartë në botë e cila gjendet në Dubai. Me këtë rast

Haradinaj i ka siguruar Agushit mbështetjen e Qeverisë për realizimin e synimit të tij për arritjen e këtij rekordi. "Kosova është vend i vogël me talentë të shumtë.

Impresionues Agim Agushi, rekordmen botëror dhe i Guinness-it për goditjen e topit me kokë. Sot mësova se caku i tij i radhës është 'Burj Khalifa' në Dubai, ndërtesa më e

lartë në botë. Agimin e sigurova për mbështetjen e Qeverisë për realizimin e synimit të tij për arritjen e këtij rekordi", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Marquezi triumfon në Gjermani

Berlin, 15 korrik - Marc Marquez e ka fituar edhe garën e Çmimit të Madh të Gjermanisë në Moto GP, e cila është zhvilluar në pistën e Sachsenring. Piloti spanjoll i Hondas triumfoi në një garë ku

dominoi gjatë gjithë kohës, duke lënë pas italianin e Yamahas, Valentino Rossi. Në podium u ngjit edhe Yamaha tjetër e Maverick Vinales, që vetëm në xhiron e fundit arriti ta parakalojë Petruccin, i katërti.

Piloti i Hondas tregoi se është superior, duke u shpëputur dhe asnjë nuk ishte në ndjekje të rivalizonte, ndërkohë që Rossi u përpoq, por shpejt u detyrua të kënaqej me vendin e dytë. Më e bukur beteja për vendin e tretë,

ku në fund Vinales mposht Petruccin. Zhgënjën motori Ducati, në vendet 6-7 me Lorenzon e Dovizioso, që nuk ishin në gjendje të rivalizonin, sidomos në pjesën e dytë të garës.



Karateistët rikthehen nga Turqia me 17 medalje

PRISHTINË, 15 KORRIK -Karateistët e Kosovës janë kthyer nga Turqia me 17 medalje të fituara, 3 medalje të arta, 6 të argjendta dhe 8 medalje të bronzta. Karateistët e Kosovës kanë marrë pjesë në turneun e njohur të karatesë "Turkey Open", ku pjesëmarrës ishin Turqia, Rusia dhe disa shtete të tjera të mëdha. Kosova në këtë turne në mënyrë ekipore është radhitur e dyta me gjithsej 17 medalje të fituara, sa kishte edhe shteti organizator, Turqia, raporton "ksp".

Ekspedita e Kosovës arriti në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" të dielën në mëngjes, ku u prit nga familjarët dhe miqtë. Sekretari i Federatës së Karatesë së Kosovës, Nazmi Gashi, u shpreh i lumtur me suksesin e arritur, pasi pjesëmarrëse ishin shtete më të mëdha e më të zhvilluara ekonomikisht se Kosova. "Gara ishte shumë e mirë. Morën pjesë 2 000 garues nga 40 shtete. Nga 40 shtete të cilat e kultivojnë karatenë në nivel shumë të fortë. Do të thotë, në nivel të



përgjithshëm Kosova u rendit ne vendin e dytë, në ekipore patëm 2 vende të para, pastaj patëm 3 vende të para në individuale, patëm gjashtë medalje të argjendta dhe 7 medalje të bronzta. Jemi shumë të kënaqur si Federatë me nivelin e të rive që po tregohet sepse krejt gara

është zhvilluar në 16 e poshtë për ne si Kosovë", ka thënë Gashi. Ndërsa karateistja Rona Ermerllahu ishte mjaft e lumtur me sukseset e arritura në aspektin individual, por edhe ato me klub, duke vlerësuar këto suksese si historike për sportin e karatesë.

Pacquiao rikthehet kampion bote

KUALA LAMPUR, 15 KORRIK - Boksieri filipinas Manny Pacquiao rikthehet kampion bote në peshën "welter", pas fitores me "KO" në raundin e shtatë ndaj argjentinasi Lucas Matthyse, ndeshje e zhvilluar në "Axiata Arena" të Kuala Lumpur, në Malajzi. 39-vjeçari filipinas, 60 fitore, 7 humbje e 2 barazime në karrierë, mori titullin e kategorisë WBA, që mbanë nga amerikano-latini, që pësoi humbjen e pestë në karrierën, ku numëron edhe 39 fitore. Një e majtë e filipinasit në raundin e shtatë çoroditi boksierin argjentinasi, që për të tretën herë gjatë këtij dueli (më parë pat rënë në tapet në raundin e tretë e të pestë) përfundoi në tapet dhe gjyqtari vendosi ta ndalte sfidën. Një sfidë e komanduar nga Pacquiao, që arrin të fitojë me "KO" pas nëntë vjetësh nga hera e fundit (2009 ndaj Cotto). Kjo tregon se filipinasi, pavarë-



sisht prej moshës, ishte i vendosur për ta fituar këtë duel ndaj rivalit të tij dhe ia doli mbanë. Tashmë filipinasi rikthehet protagonist në sportin e boksit, duke vijuar karrierën legjendare, ndërsa argjentinasi Matthyse ka zhvilluar një përballje jo në lartësinë e tij. Kjo fitore i hap

dyert Pacquiao për një sfidë edhe më të madhe në peshën "welter", këtë herë ndaj Vasy Lomachenko, përballje që me shumë gjasa do të zhvillohet në dhjetor të këtij viti. Por, rival mund të jetë edhe Terence Crawford, një tjetër kampion bote.

SHKURT

De Laurentiis: Ronaldo na u ofrua, por e refuzuam

Në Torino janë shtuar ethet për ardhjen e Cristiano Ronaldos, i cili do ta bëjë prezantimin e tij si futbollist i Juventusit pasditen e së hënës. Për portugezin ka folur edhe presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentiis, i cili ka zbuluar diçka vërtet interesante, teksa theksoi se Ronaldo iu ofrua edhe skuadrës së tij. "Ronaldo iu ofrua edhe Napolit. Agjenti i tij Mendes më telefonoi. Formuam edhe ofertën tonë dhe ishim gati ta paguanim Ronaldon me përqindjet e të ardhurave që do të siguronim nga ardhja e tij. Por, 350 milionë eurot që do të investojë Juventus për të janë të paarritshme. Do ta rrezikonim falimentimin e klubit për këtë investim", ka thënë De Laurentiis për "La Repubblica".

Shkarkohet trajneri i Argjentinës

Federata Argjentinase e Futbollit (AFA) ka njoftuar se Jorge Sampaoli nuk është më trajneri i kombëtares së Argjentinës. Sampaoli kishte kontratë deri në vitin 2022 por, pas dështimit të Argjentinës në Kupën e Botës, marrëveshja u ndërpre me pëlqim të dyanshëm, kurse trajneri do të përfitojë 2 milionë euro.

Kerberi triumfon në Wimbledon

Angelique Kerber ka fituar turneun e Wimbledonit për femra, pasi mposhti 2-0 me sete amerikanen Serena Williams. Në një sfidë që zgjati pak më tepër se një orë, gjermania u imponua dy herë me rezultatin 6-3 ndaj motrës së vogël Williams. Kjo ishte hera e parë që Kerber fiton Wimbledonin. Gjermania mbante numrin 10 të renditjes ATP para kësaj finaleje, por natyrisht se pritet të ngrihet më lart pas këtij triumfi.

Southgate: Botëror i suksesshëm për Anglinë

Kombëtarja e Anglisë është larguar si e katërta nga Kampionati Botëror "Rusia 2018". Në ndeshjen për vendin e tretë, anglezët pësuan humbje nga Belgjika me rezultat 2-0. "Krejt në fund ne jemi krenarë për të arriturat në këtë botëror. Kemi përfunduar në mesin e katër kombëtareve më të mira, por e dinim se nuk ishim më të mirët. Kemi bërë lojëra mjaft të mira në këtë botëror. Ka qenë një aventurë fantastike", ka thënë trajneri i Anglisë, Gareth Southgate.

Di Maria, afër Interit

Skuadra e Interit ende nuk i ka përfunduar transferimet në këtë afat kalimtar. Mediet në Argjentinë raportojnë se ylli i PSG-së, Angel Di Maria, mund të jetë lojtar i ri i kësaj skuadre. Interi me trajnerin Luciano Spalletti po mendon të krijojë një ekip konkurrues ku synim kryesor ta ketë triumfin në garën për "Scudetto".

Andersoni, transferimi i shtatë i West Hamit

West Ham Unitedi, pas transferimit të Ryan Fredericks, Lukasz Fabianski, Issa Diop, Jack Wilshere, Andriy Yarmolenko dhe Fabian Balbuena, ka transferuar edhe Felipe Andersonin nga Lazio. Andersoni ka nënshkruar kontratë katërvjeçare, teksa transferimi i tij thuhet se ka kushtuar plot 42 milionë funte apo 47.5 milionë euro, duke u bërë rekord i klubit. "West Ham United është i lumtur ta konfirmoj nënshkrimin rekord të klubit me mesfushorin sulmues të Lazios, Felipe Anderson. Brazilini, i cili është edhe përfaqësues i kombëtares, shënoi tetë gola dhe ndihmoi me dhjetë asistime në 32 paraqitjet e tij për klubin e Romës në sezonin e kaluar", thuhet në njoftimin e West Hamit.

	Autor: GAZMEND MORINA					KËNGËTARJA SHQIPTARE NË FOTO	SECILA NGA PJESET QË FORMOJNË NJË TË TËRË	POLITIKANI ITALIAN XHANFRANKO	SEND QË PËRDORET PËR TË LUAJTUR (shq.)	“T” në mes të dy “E”	BASHKËT.	SOKOL BASHOTA	EPOKA ERE	TË FIKËT	ARMË GJAHU ME NJË TYTË DHE ME FISHEKË SI TË ÇIFTES	OLIVER NEUVILLE
	VEPRIM I VETVETISHËM DHE I MENJ- ËHERSHËM												PËREMËR VETOR FUTBOLLISTI BAJRAMI			
	KONGRESMEN I AMERIKAN ENGEL										AKTORJA DHE MODELJA RODRIGUEZ SPORTIST QË MERRET ME NOT					
	ISH FUTBOLLISTI HOLANDEZ BOUDEWIJN											SHOK, JARAN LECCE				SHKRIMTARI KELMENDI
	EMËR MASHKULLI MYSLIMAN									REGJISORI I FAMSHËM STONE RIFAT KUKAJ						
	RENIUM							TË BUKURIT (pashq.) ELEMENT KIMIK (TA)				RAMADAN AVDIU EMËR YNI MASHKULLI			ZANORE GOJËTAR	
	ROK BEND I YNI								DREJTIM QËLLIM I PARAMEND- UAR				LIGJ, KANUN (vjet.) NJË PLANET			
	SULM, MËSYMJE									KORNIZË TUNDEM, LËKUNDEM, SHKUNDEM ME FORCË				“RIZONI” FUTBOLLISTI YNË ZEJNULLAHU		
EPOKA ERE	FILM I REGJISORIT ISA QOSJA	I EMËROVA NË NJË DETYRË	THIKË QË MBAHEJ SI ARMË BREZI (sh.shq.)	NEGRI, ZEZAK	KËSTI BANKAR	BINARËT E TRENIT ZANORE					DOLLAP I VOGËL PËR TË MBAJTUR ZOGJ					
BIMË QË BËN KOKRRA TË VOGLA E QË HAHEN								TERMINATE STAY RESIDENT QË RUHET NGA DIKUSH; I			PASURI E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA DEM, KA					QË PËRSHKOHET NGA PATOSI
RRETHI QË VIHET NË GISHT I STOLI ARI						BEKIMET						SHENJË NDALESE BESNIK (perkdh.)				
KRYENGRITËS QË DILTE MALIT E LUFTONTE PËR LIRINË E ATDHEUT						“RULERA” ROLL BACK MALARIA			NËNNNDARJE E NJË LIGJI GURRAT				NJËSI KOHE KËNGËTARJA E FAMSHME FRANKLIN			
AKTORJA E SHQUAR THURMAN				REGJISORJA KALLABA VENDLINDJA E ODISEUT				AKTORI MORINA BANOR I NJË SHTETI AZIATIK							TOTENHAM 365 DITË	
GOJËDHËNA					PEMË E VENDEVE TË NGROHTA E QESHURA TALLËSE						KADRI ROSHI I KORR			PRODUKT I PULËS TËRËSI E ORENDIVE		
INDIUM			REGJISORI AMERIKAN BURTON NJË PIJE ALKOOLIKE				NDËRRIMI I MALLIT (krah.) KALJARI					ALBANOLOGIA DURHAM LETRARI ... ASLLANI				
EPOKA ERE	VEZAK SHTET FEDERAL NË SHBA					LAJM HAP BRUMIN ME PETËS				SECILA NGA DY BRINJËT E NJË TREKËNDËSHI BIMË QË PËRDORET SI USHQIM (sh.shq.)						
JURIST QË JEP NDIHMË E KËSHILLA PËR ÇËSHTJE TË DREJTËSISË							NOTË MUZIKORE FUQI, FORCË		BANOR I NJË SHTETI TË MADH EVROPIAN FIGURË SHAHU						BASHKËT. KRITERE	
RADIOLOK- ATORËT								PËRÇARJE BASHKËT.					OHAJO, PENSILVANIA TOKË E BUKËS (sh.shq.)			KONFERENCË ME KARAKTER NDËRKOMB- ËTAR
ZANORE		KORÇA REPERI I FAMSHËM DOGG (shqip.)		I ÇEL				KALI I SHALËS POETI VINCA				NËPËR ARA, ARAVE VAJ KUZHINË QË PRODHOHET NË SHQIPËRI				
ZEN SUPPLIERS AUTOMOTIVE				BASHKË, ME (bised.) KËMBËZ SHKALLE, SHKALLARE			DILETANT ZET, RENIUM							RESHAT ARBANA AKTORJA E FAMSHME AMERIKANE RICHARDS		
OLIVIA NORMAN			POPULL QË KA BANUAR NË PELLGUN E EGJEUT (hist.) SELEN								LAKESË KAM DIJENI PËR DIÇKA					
FEMRAT E PORSAMA- RTUARA						NUMËR THEMELOR TREVISO			BOTIMI EVERTON							
OREKS							PËRHAPJE E VALËVE						AKTORI HOLLIVUDIAN ... DAMON (perkdh.)			

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: “Liria”- Fortesë

Komuna: Rahovec

Data: 16.07.2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/157 - ESIP/SDG/157-G/1.2	Blerja e Tabelave elektronike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles “Liria”- Fortesë-Rahovec. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Blerja e Tabelave elektronike -2 copë

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

• Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;

• Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e shkolles “Liria”- Fortesë-Rahovec, më së largu deri më 24.07. 2018.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t’ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t’i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Elhami Zhuniqi

Telefoni: 044269022

E-maili: elhami-dervishi@hotmail.com

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Nallat, Rr. Bajram Kelmendi

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Administratës Publike

Ministarstvo Javne Uprave-Ministry of Public Administration

KORIGJIM I KONKURSIT

Ministria e Administratës Publike korrigjon, Konkursin për Pozitën Drejtor të Bordit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të publikuar më datë 13.07.2018, te afati i konkursit është lëshuar një gabim teknik e duhet të jetë:

Afati për pranimin e dokumentacionit është nga data 13 korrik deri me 11 gusht 2018.

Kushtet dhe kriteret tjera të konkursit mbeten të pa ndryshuara.

KOREKTCIJA KONKURSA

Ministarstvo Javne Uprave ispravlja konkurs za poziciju Direktor odbora operatera prenosnog sistema objavljenog datuma 13.07.2018, u roku konkursa je napuštena jedna greška, treba da bude:

Rok prijema dokumentacije je od 13 jula do 11 avgusta 2018 god.

Ostali kriteri konkursa ostaju ne promenjenih.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Sahit Thaçi - nga Malisheva, shpallë të pavlefshme të humbur certifikatën e invalidit të UÇK-së.

► Shpetim Gashi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmm "Lotenc Antoni" Prizren.

► Avdyl Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmm "Luciano Motroni" Prizren.

► Elza Maloku shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Avdyl Frasheri " Prizren.

► Urgjentisht kërkoj një banës me qera për një person te huaj, Banesa duhet te jete jo shumë larg qendrës, mundësisht tek "Qafa" ose "Tophane" Duhet te ketë dy dhoma gjumi, te jete e mobiluar bukur. Çmimi deri 300 euro. Për info: Tel 049-472-770

► Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perlleshi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

Prishtinë



UNIVERSITETI I GJAKOVËS
"FEHMI AGANI"

Rr. ISMAIL QEMALI, pn 50 000 GJAKOVË, Republika e Kosovës
Tel: 038 200 20 831

Data: 13.07.2018
Nr.ref : 03/712

Universiteti i Gjakovës, në bazë të nenit 22 pika 1.7, nenit 28 pika 1.5 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit Publik të Gjakovës dhe Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani", ri - shpallë :

KONKURS

-Departamenti i Administratës së Përgjithshme-

-Zyrtar/e për Administrimin e Teknologjisë Informative - TI (1 nëpunës/e)

Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për Shërbyesit Civilë të Republikës së Kosovës, nr 03/L-049, duhet ti plotësojnë edhe këto kushte:

Detyrat Kryesore:

1. E administron web-faqen e Universitetit dhe njësive të tij.
2. Përgatitë dhe operon me të dhënat e studentëve nga procesi i regjistrimit deri tek diplomimi, përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Studentëve;
3. U jep përkrahje personelit akademik dhe administrativ për sistemet e TI në Universitet;
4. Jep përkrahje softuerike dhe harduerike për Universitetin dhe Fakultetet;
5. Jep përkrahje për rrjetin dhe internetin e Universitetit dhe Fakulteteve;
6. E pregaditë konfigurimin e kompjuterëve për operim funksional;
7. Ndihmon në implementimin e proceseve administrative;
8. Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton Sekretari i Përgjithshëm.

Kualifikimi:

Përgatitja shkollë superiore/Diplomë universitare – FIEK- Drejtimi Kompjuterikë, Telekomunikacion, FSHMN – Drejtimi i Shkencave Kompjuterike; Minimum 2 (dy) vite përvojë pune në fushën përkatëse

Kohëzgjatja:

E karrierës

Qëllimi i vendit të punës:

Të kryej detyrat dhe përgjegjësitë sipas mandatit brenda njësisë organizative.

Shkathtësitë:

- E nevojshme njohja e punës me kompjuter në programet Word, Excel, Corel etj.
- E nevojshme njohja bazike e gjuhëve programuese PHP, HTML, CSS etj.
- Të nevojshme njohuritë bazike në SQL.
- E dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

Konkursi mbetet i hapur deri me dt. 27.07.2018 (15 ditë kalendarike).

Shkarkimi i aplikacioneve bëhet nga web faqja e Universitetit www.uni-gjk.org, ndërsa paraqitja e dokumenteve bëhet në zyrën e Arkivit në ndërtesën e Rektoratit të Universitetit "Fehmi Agani" Rr Ismail Qemali pn, Gjakovë

Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- Një letër motivuese
- CV-në
- Dëshmi mbi shkollimin e kryer (kopja e diplomës e noterizuar)
- Dokumente tjera relevante për pozitën që aplikoni
- Çertifikata se nuk jeni nën hetime, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj

Sherbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.
Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adresë:
www.uni-gjk.org



UNIVERZITETI I GJAKOVICËS
"FEHMI AGANI"

UI. ISMAIL QEMALI, bb, 50000 DJAKOVICA, Republika Kosovo
Tel.: 038 200 20 831

Datum: 13.07.2018
Nr.Ref: 03/712

Univerziteti i Gjakovës, na osnovu člana 22 tačka 1.7, člana 28 tačka 1.5 Privremenog Statuta Javnog Univerziteta Djakovice i Pravilnika o Unutrašnjem Organizovanju i Sistematizaciji Radnih Mesta na Univerzitetu Djakovice "Fehmi Agani", ponovno objavljuje:

KONKURS

-Odeljenje Opšte Uprave-

-Službenik/ca za Informativnu Tehnologiju –IT (1 službenik/ca)

Kandidati koji konkurišu za ovo radno mesto, osim opštih uslova predviđenih Zakonom o Gradjanskim Službenicima Republike Kosovo, br. 03/L-049, trebaju ispuniti i sledeće uslove:

Glavne dužnosti:

1. Upravlja web-stranom Univerziteta i njegovih jedinica.
2. Priprema i upravlja sa podacima studenata od procesa registracije do diplomiranja, preko Elektronskog Sistema Upravljanja Studenata;
3. Daje podršku akademskom i upravnom osoblju za sisteme IT na Univerzitetu;
4. Daje softver i hardver podršku za Univerzitet i Fakultete;
5. Daje podršku za mrežu i internet Univerziteta i Fakulteta;
6. Vrš i druge poslove koje mu odredjuje Generalni Sekretar.

Kvalifikacija:

Viša školska sprema – FEIK-Pravac Kompjuterstvo Telekomunikacija, FPMN – Pravac Kompjuterske Nauke - (2) godine radnog iskustva na odgovarajućem polju

Trajanje:Karijerno

Sposobnosti:

- Potrebno je poznavanje rada sa računarom u programima Word, Excel, Corel itd.
- Potrebno je osnovno poznavanje programskih jezika PHP, HTML, CSS etj.
- Potrebno je osnovno poznavanje u SQL.
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

Konkurs ostaje otvoren do 27.07.2018 (15 kalendarskih dana). Prijava dokumenata se vrši u kancelariji Arhiva u zgradi Rektorata Univerziteta "Fehmi Agani" Ulica Ismail Qemali bb, Djakovica

Molbi/Zahtevu treba priložiti i sledeće dokumente:

- Jedno motivacijsko pismo
- Životopis
- Dokaz o završenom školovanju (kopija ovjerene Diplome)
- Druge relevantne dokumente o položaju za koji konkurišete
- Uverenje da niste pod istragom, ne starija od šest (6) meseci

Gradjanska Služba Kosova nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova i prima molbe od svih lica muškog i ženskog roda od svih zajednica na Kosovu.

Nevećinske zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravedno i srazmerno zastupanje u organima gradjanske službe centralne i lokalne javne uprave, kao što se navodi u članu 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 o Gradjanskoj Službi Republike Kosovo.

Molbe podnesene posle predviđenog roka se neće primati a nekompletne molbe biće odbijene.
Samo izabrani kandidati u užoj listi će biti kontaktirani.

Konkurs se može naći objavljen i na strani interneta na sledećoj adresi:
www.uni-gjk.org



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA “RITMO – L”

**Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333